



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 10 tetor 2023  
Nr. ref.: AGJ 2289/23

## **AKTGJYKIM**

në

**rastin nr. KI90/23**

Parashtrues

**Shqipdon Fazliu**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [ARJ. nr. 114/2022]  
të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 23 dhjetorit 2022**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar dhe  
Enver Peci, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Shqipdon Fazliu nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës). Parashtruesi i kërkesës përfaqësohet nga Flakron Sulejmani, avokat nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [ARJ. nr. 114/2022] të 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) lidhur me Aktvendimin [AA. nr. 650/2022] e 1 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktvendimin [A.nr.1875/22] e 2 gushtit 2022 të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).
3. Aktgjykimi i kontestuar [ARJ.nr.114/2022] i Gjykatës Supreme i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 janar 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, përmes të cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe me nenin 10 (pa titull) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
6. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur, e cila ka shfuqizuar Rregulloren e punës së Gjykatës Kushtetuese nr. 01/2018. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr.01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr.01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

7. Më 28 prill 2023, përfaqësuesi i parashtruesit të kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 3 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [nr. GJR.KI90/23], caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues, ndërsa përmes Vendimit [nr. KSH.KI90/23], caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, kryesuese dhe Safet Hoxha dhe Remzije Istrefi-Peci, anëtarë.

9. Më 4 maj 2023, Gjykata e pranoi një shkresë nga Presidentja e Republikës së Kosovës, përmes të cilës, kërkohet njoftim nga Gjykata lidhur me *“ndonjë kërkesë eventuale kushtetuese”* në ndërlidhje me *“procedurat që janë zhvilluar në Këshillin Prokurorial të Kosovës për përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit”* dhe në të cilën, ndër tjerash, theksohet që, *“Duke qenë se Aktgjykimi Refuzues i Gjykatës Supreme është shpallur më 27 dhjetor 2022, kjo nënkupton njërën datë nga e cila ka filluar të rrjedhë afati 4 mujor. Por, Zyra e Presidentes së Republikës së Kosovës nuk mund të ketë informacion për kohën kur Aktgjykimi i mësipërm i është dorëzuar palës, rrjedhimisht kur mund të përfundojë afati 4 mujor bazuar në datën e pranimit të aktgjykimit nga pala”* dhe *“prandaj, meqë këto afate ndërlidhen edhe me veprimet e Presidentes në procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, kërkojmë me respekt nga Gjykata Kushtetuese të na njoftojë nëse ka pranuar ndonjë kërkesë kushtetuese individuale nga kandidatët që i janë nënshtruar procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, të zhvilluar në KPK, pas shterimit të afateve kushtetuese dhe ligjore dhe pas shkresës së fundit njoftuese të Gjykatës Kushtetuese, të datës 14.04.2023”*. Më 12 maj 2023, Gjykata iu përgjigj Presidentes së Republikës, duke theksuar që (i) *“Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, sipas dispozitave përkatëse të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe Rregulloren e saj të punës, i njofton palët përkatëse, përfshirë palët e interesuara, për lëndët e regjistruara në Sekretarinë e saj”*; dhe (ii) *“sikurse në lidhje me shkresën që keni dërguar në Gjykatë më 7 prill 2023, po ashtu edhe lidhur me shkresën tuaj të 4 majit 2023, në të cilën kërkoni të informoheni nëse është pranuar ndonjë kërkesë individuale nga kandidatët që i janë nënshtruar procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, Gjykata, në frymën e komunikimit institucional, ju njofton se më 28 prill 2023, ka regjistruar kërkesën KI90/23 me parashtrues z. Shqipdon Fazliu. Kërkesa e lartcekur është kërkesë individuale, përmes të cilës kontestohet Aktgjykimi [ARJ. nr. 114/2022] i 23 dhjetorit 2022 i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës”*.
10. Dy shkresat e lartcekura ndërlidhen me shkresën e parë të Presidentes së Republikës të 7 prillit 2023 drejtuar Gjykatës përmes të cilës kishte kërkuar njoftim nëse Gjykata *“ka pranuar ndonjë kërkesë kushtetuese individuale nga kandidatët që i janë nënshtruar procesit të përzgjedhjes së kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit”*, duke sqaruar, ndër tjerash, që këtë kërkesë e adreson në mënyrë që *“të sigurohem se çfarëdo veprimi që ndërmarrë unë si Presidente e Republikës së Kosovës, në lidhje me procesin dhe procedurat e emërimit të Kryeprokurorit të Shtetit, të mos ndikoj në procedurat eventuale që janë duke u zhvilluar apo që potencialisht mund të zhvillohen në Gjykatën Kushtetuese”*. Kësaj shkrese Gjykata Kushtetuese i ishte përgjigjur më 14 prill 2023, duke theksuar që Gjykata nuk ka ndonjë kërkesë nga individë që kontestojnë procedurat gjyqësore që janë zhvilluar para gjykatave të rregullta lidhur me procesin e lartcekur.
11. Më 8 maj 2023, Gjykata njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi Gjykatës Themelore një kopje të kërkesës dhe njëkohësisht, i kërkoi Gjykatës Themelore që të dorëzojë në Gjykatë dëshminë se kur i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës Aktgjykimi i kontestuar.
12. Më 11 maj 2023, Gjykata Themelore dërgoi dëshminë, përkatësisht fletë-kthesën që konfirmon se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 10 janar 2023.
13. Më 28 shtator 2023, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës pranueshmërinë e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata vendosi njëzëri: (i) të deklarojë të pranueshme kërkesën; dhe (ii) të konstatojë që Aktgjykimi [ARJ. nr. 114/2022] i 23 dhjetorit 2022 i Gjykatës Supreme në ndërlidhje

me Aktvendimin [ AA.nr. 650/2022] e 1 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A.nr.1875/22] e 2 gushtit 2022 të Gjykatës Themelore, nuk janë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **Përmbledhja e fakteve**

14. Gjykata që në fillim të përmbledhjes së fakteve të kërkesës së parashtruar konsideron se është e nevojshme të reflektojë një përshtetje të gjendjes faktike lidhur me veprimet dhe procedurat që janë iniciuar dhe zhvilluar nga parashtruesi i kërkesës deri në momentin e parashtrimin të kësaj kërkesë në Gjykatë. Me këtë qëllim, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës, ka qenë kandidat pjesëmarrës në konkursin, përkatësisht procedurën e përzgjedhjes për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, të shpallur më 14 janar 2022 nga Këshilli Prokurorial i Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK). Në këtë kontekst, Gjykata në vijim, do të paraqesë në mënyrë të përmbledhur (i) procedurën e ndjekur nga KPK përkitazi me propozimin e kandidatit për Kryeprokuror sipas shkresave të dorëzuara në Gjykatë; (ii) kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë përkitazi me këtë proces të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, regjistruar në Gjykatë si KI57/22 dhe KI79/22; dhe (iii) kërkesëpadinë përkitazi me këtë proces të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës para gjykatave të rregullta dhe konstatimet përfundimtare të të cilave kontestohen para Gjykatës përmes këtij rasti.

(i) *procedura e ndjekur nga KPK lidhur me përzgjedhjen e kandidatit për Kryeprokurorë të Shtetit*

15. Më 14 janar 2022, KPK shpalli konkursin për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit bazuar në Rregulloren Nr.06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja për Emërimin e Kryeprokurorit). Më 18 mars 2022, kandidatët për Kryeprokuror të Shtetit, përfshirë parashtruesin e kërkesës, i janë nënshtruar procesit të intervistimit nga Paneli vlerësues i KPK-së. Intervistimi i kandidatëve ishte transmetuar përmes Radio Televizionit të Kosovës.
16. Më 22 mars 2022, Kryesuesi i Panelit vlerësues përmes “*Njoftimit Përfundimtar [nr. 419/2022]*”, (i) kishte njoftuar parashtruesin e kërkesës që i njëjti është radhitur i dyti në konkurrencë me kandidatët tjerë dhe për pasojë, nuk i ishte përcjellë KPK-së si kandidat përfundimtar për votim; (ii) i kishte dorëzuar poentimin përfundimtar nga të gjithë anëtarët e Panelit vlerësues të anonimizuar dhe poentimin individual i anonimizuar, i dhënë nga secili anëtar i Panelit vlerësues, bashkë me arsyetimin për secilën kategori vlerësimi; dhe (iii) e kishte udhëzuar në të drejtën e ankesës përkitazi me vlerësimet dhe poentimet e Panelit vlerësues në Komisionin për rishqyrtim të KPK-së.
17. Më 23 mars 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë tek Sekretariati i KPK-së duke kërkuar qasje në dosjet e kandidatëve të tjerë dhe në vlerësimin dhe poentimin e tyre, duke theksuar se në të kundërtën e ka “*të pamundur të ushtroj efektivisht mjetin juridik*”. Në po të njëjtën ditë, parashtruesi i kërkesës pranoi njoftimin nga KPK që bazuar në nenin 15 (Njoftimi i kandidateve) të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit, kërkesa për të pasur qasje në dosjet dhe poentimet e kandidatëve të tjerë, është refuzuar.
18. Më 28 mars 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kundërshtim para Komisionit për rishqyrtim brenda KPK-së, duke pretenduar (i) moszbatim të dispozitave të Ligjit

për KPK-në; (ii) moszbatim të dispozitave të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit; dhe (iii) poentim të pasaktë. Në esencë dhe ndër tjerash, parashtruesi i kërkesës pretendoi që (i) Rregullorja për Emërimin e Kryeprokurorit është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për KPK-në; (ii) përmes propozimit të vetëm një kandidati për vlerësimin e KPK-së, të njëjtës i është pamundësuar zgjedhja në mes të alternativave, në kundërshtim me Ligjin për KPK-në, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI34/17, me parashtruese *Valdete Daka*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr. 50/2017, të 6 marsit 2017 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI34/17) dhe me Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë CDL-AD(2015)039, CDL-AD(2005)039, CDL-PI(2015)001; (iii) refuzimi i qasjes në dosjet dhe poentimet e të gjithë kandidatëve tjerë, i ka pamundësuar ushtrimin efektiv të mjetit juridik në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për KPK-në; dhe (iv) poentimi i katër (4) anëtarëve të Panelit vlerësues të KPK-së ka qenë i pasaktë, sepse të njëjtit nuk kanë arsyetuar zbritjen e pikëve nga maksimumi i pikëve të lejuara përkitazi me kriteret mbi bazën e të cilave bëhet vlerësimi sipas Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit ose arsyetimi përkatës nuk ka qenë i saktë dhe i bazuar.

19. Më 1 prill 2022, Komisioni për rishqyrtim i KPK-së trajtoi kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës, ndërsa me 4 prill 2022, i dorëzoi raportin përkatës KPK-së. Komisioni për rishqyrtim, (i) refuzoi si të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me moszbatim të Ligjit për KPK-në dhe Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit; por (ii) rekomandoi që pjesërisht të miratohen kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, vetëm sa i përket pretendimit për poentim të pasaktë, me propozimin që anëtarët e Panelit vlerësues të rishikojnë edhe një herë procesin rreth arsyetimit të poentimit përkatës. Në këtë kontekst, sa i përket kundërshtimit të parashtruesit të kërkesës, përkitazi me vlerësimin e anëtarëve të Panelit vlerësues me kodet 159 FTC, 214 LOD, 142 OID dhe 430VIK lidhur me kriteret e përcaktuara përmes nenit 13 (Kriteret për poentim) të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit, përkatësisht (i) "*integriteti i kandidatit*"; (ii) "*njohuritë teknike dhe përvoja*", (iii) "*shkathtësitë udhëheqëse dhe menaxheriale*"; dhe (iv) "*koncepti dokumenti dhe prezantimi*", Komisioni për rishqyrtim i KPK-së propozoi që të aprovohet kundërshtimi, duke vlerësuar që anëtarët përkatës të Panelit vlerësues mund të arsyetojnë zbritjen e pikëve përkatëse në raport me pikët maksimale të saktësuara për secilin kriter vlerësimi. Pjesa tjetër e kundërshtimit, sa i përket poentimit të pasaktë, u refuzua sepse Komisioni për rishqyrtim gjeti se poentimi ishte në harmoni me arsyetimin e dhënë nga ana e anëtarëve të Panelit vlerësues të KPK-së.
20. Më 6 prill 2022, KPK mbajti takim, në të cilin, (i) shqyrtoi Raportin e Komisionit për rishqyrtim; dhe (ii) zhvilloi votimin për propozimin e kandidatit për pozitë të Kryeprokurorit të Shtetit.
21. Përkitazi me shqyrtimin e raportit të Komisionit për rishqyrtim, KPK përmes Vendimit [KPK.nr-470/2022], refuzoi të njëjtin, duke arsyetuar, ndër tjerash, që (i) vlerësimet dhe arsyetimet e anëtarëve të Panelit vlerësues janë në harmoni me Udhëzuesin për nenet 13 (Kriteret e poentimit) dhe 14 (Procesi i poentimit) të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit; (ii) anëtarët e Panelit vlerësues kanë vepruar në përputhje me nenin 14 (Procesi i poentimit) të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit; (iii) përmbledhja e arsyetimit të vlerësimit për kriteret përkatëse nga ana e anëtarëve të Panelit vlerësues, përputhet me poentimin e bërë, me prezantimin e kandidatit gjatë intervistës dhe dosjen e vlerësimit; dhe (iv) edhe po të plotësoheshin më tej arsyetimet përkatëse, kjo nuk do të rezultonte në ndryshim të poentimit dhe rrjedhimisht, nuk do të ndikonte në rezultatin përfundimtar, përkatësisht renditjen e kandidatëve për propozim për Kryeprokuror të Shtetit.

22. Përkitazi me votimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit të propozuar nga Paneli vlerësues, KPK përmes Vendimit [KPK.nr-475/2022] vendosi që (i) z. Blerim Isufaj, përkatësisht kandidati i radhitur si i pari nga procedura e vlerësimit, të nominohet për Kryeprokuror të Shtetit; (ii) z. Blerim Isufaj, t'i propozohet Presidentes për emërim si Kryeprokuror i Shtetit; (iii) "*propozimi për emërim të jetë i arsyetuar me shkrim duke përfshirë gjithë procesin e nominimit të kandidatit të propozuar për emërim për Kryeprokuror të Shtetit*"; (iv) obligoi Sekretariatit e KPK-së që këtë Vendim ta publikojë në uebfaqe; dhe (v) theksoi që vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga KPK.
23. Në të njëjtën datë, përkatësisht më 6 prill 2022, parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar Vendimi [Nr.474/2022] i KPK-së për refuzimin e Raportit të Komisionit për Rishqyrtim.

*(ii) kërkesa e parë e parashtruar në Gjykatën Kushtetuese, e regjistruar si KI57/22 dhe KI79/22*

24. Më 28 prill 2022, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Kushtetuese, duke kontestuar kushtetutshmërisë e (i) Vendimit [KPK/nr.474/2022] për Refuzimin e Raportit të Komisionit për rishqyrtim; dhe (ii) Vendimit [KPK/Nr.475/2022] për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, që të dyja vendime të KPK-së të 6 prillit 2022. Gjykata e regjistroi kërkesën e parashtruesit të kërkesës me shenjën KI57/22.
25. Më 13 maj 2022, Gjykata e kishte njoftuar parashtruesin, në cilësinë e tij si parashtrues i kërkesës në rastin KI57/22, për regjistrimin e kësaj kërkesë dhe i kishte kërkuar, ndër tjerash, ta informojë Gjykatën nëse ka iniciuar ndonjë procedurë në gjykata të rregullta lidhur me aktet e kontestuar të KPK-së. Në përgjigjen e ofruar më 20 maj 2022, parashtruesi i kërkesës kishte sqaruar se nuk kishte iniciuar asnjë procedurë në gjykata të rregullta lidhur me aktet e kontestuar të KPK-së.
26. Më 4 korrik 2022, Gjykata, pas shqyrtimit të kërkesave të bashkuara në rastin KI57/22 dhe KI79/22, kishte vendosur se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme për shqyrtim në merita për arsye procedurale, përkatësisht sepse kërkesa e parashtruar nuk plotësonte kriterin e shterimit të mjeteve juridike të përcaktuar përmes paragrafit 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës.
27. Në të njëjtën datë, përkatësisht më 4 korrik 2023, në ueb-faqen e Gjykatës u publikua një komunikatë lidhur me vendimmarrjen e Gjykatës në këtë rast. Komunikata theksonte, ndër tjerash, se "*Gjykata, vendosi që kërkesat përkatëse t'i shpallë të papranueshme mbi baza procedurale, sepse parashtruesit e kërkesave nuk i kanë shteruar mjetet juridike siç është përcaktuar me paragrafin 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*" dhe përvijonte shkurtimisht arsyetimin rreth kësaj pjese të dispozitivit të Aktvendimit për Papranueshmëri në rastet e bashkuara KI57/22 dhe KI79/22.
28. Më 26 korrik 2022, Aktvendimi për Papranueshmëri në rastet e bashkuara KI57/22 dhe KI79/22, ju dorëzua parashtruesve të kërkesave përkatëse, si dhe u publikua në Gazetën Zyrtare dhe në uebfaqen e Gjykatës.

*(iii) procedurat e ndjekura para gjykatave të rregullta*

29. Më 28 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore padi për iniciimin e konfliktit administrativ me propozimin për caktimin e sigurimit të

kërkesëpadisë me masën e përkohshme, përkatësisht kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të akteve të kontestuara të KPK-së. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar anulimin apo shpalljen të pavlefshme të (i) Vendimit të KPK-së [KPK.nr-475/2022] të 6 prillit 2022, përmes së cilit, ndër tjerash, kandidati tjetër i ishte propozuar Presidentes për emërim si Kryeprokuror i Shtetit; dhe (ii) Vendimit të KPK-së [KPK.nr.474/2022] të 6 prillit 2022, përmes të cilit ishte refuzuar raporti i Komisionit për rishqyrtim. Njëkohësisht, përmes kërkesës për masë të përkohshme, kishte kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të dy akteve të lartpërmendura të KPK-së. Parashtruesi i kërkesës e bazoi kërkesëpadinë e tij në paragrafin 2 të nenit 28 (pa titull) dhe nenin 63 (Dispozita të tjera të procedurës) të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative (në tekstin e mëtejme: LKA), si dhe në nenet 129 (pa titull) dhe 130 (pa titull) të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejme: LPK).

30. Përmes padisë së lartcekur të parashtruar në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës, kishte ngritur pretendime që ndërlidhen me (i) afatshmërinë e padisë përkatëse; dhe (ii) ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e akteve të kontestuara të KPK-së.
31. Në kuptim të afatshmërisë së kërkesëpadisë së paraqitur në Gjykatën Themelore, parashtruesi i kërkesës, i referohet (i) paragrafit 2 të nenit 28 dhe nenit 63 të LKA-së; dhe (ii) neneve 129 dhe 130 të LPK-së. Më saktësisht dhe në esencë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Themelore që (i) të trajtojë padinë e tij si të afatshme në kontekst të paragrafit 2 të nenit 28 të LKA-së, me pretendimin që kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së paraqitur në Gjykatën Kushtetuese më 28 prill 2022, ka qenë rezultat i *“mos dijës apo e gabimit të hapur”* dhe për pasojë, padia në Gjykatën Themelore duhet të konsiderohet që *“është paraqitur me kohë”*; dhe (ii) të lejoj kthimin në gjendje të mëparshme në kontekst të paragrafit 1 të nenit 129 të LPK-së. Në mbështetje të pretendimeve të tij në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, kishte theksuar, *“kjo kërkesë nuk ju është dorëzuar Gjykatës Themelore në Prishtinë por një organi tjetër siç është Gjykata Kushtetuese e Kosovës, duke mos ditur se kjo Gjykatë, do të veprojë në këtë rast ndryshe nga rastet e mëhershme kur krijoi një precedent në rastin e ish Kryeprokurorit të Shtetit dhe vendosi në mënyrë meritore rreth rastit. Më vonë e konsolidoi praktikën e tillë duke pranuar dhe duke vendosur në mënyrë të njëjtë edhe në dy raste të tjera. Paditësi nuk e ka ditur se këto raste nuk do të shërbenin si precedent nga Gjykata Kushtetuese për kërkesat e palëve si standard i krijuar nga vet kjo Gjykatë dhe për këtë arsye nga mosdija kërkesa ju është dorëzuar organit tjetër kompetent siç është Gjykata Kushtetuese dhe nuk ju është dorëzuar Gjykatës Themelore në Prishtinë.”*
32. Ndërsa, në kuptim të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara, parashtruesi i kërkesës kishte ngritur pretendime që ndërlidhen me (i) ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit të KPK-së; dhe (ii) mënyrën e poentimit nga anëtarët e Panelit vlerësues të KPK-së.
33. Për sa i përket Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit, parashtruesi i kërkesës kishte pretenduar që e njëjta është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për KPK-në, ndër tjerash, sepse (i) nuk përcakton mjet juridik përmes të cilit mund të kontestohet Vendimi i KPK-së për propozimin e kandidatit për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit, në kundërshtim me nenet 32 dhe 54 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 13 të KEDNJ-së; (ii) në nenin 17 (Procesi i votimit) të saj, Rregullorja përcakton që nëse dallimi në poentim në mes të kandidatit të parë dhe të dytë sipas propozimit të Panelit vlerësues është më shumë se 3%, atëherë vetëm kandidati i radhitur si i pari, i nënshtrohet procesit të votimit nga KPK dhe se kjo

dispozitë, duke marrë parasysh që i pamundëson KPK-së të zgjedhë në mes të të paktën dy alternativave, është në kundërshtim me Kushtetutën, Ligjin për KPK-në, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI34/17 dhe Opinionet relevante të Komisionit të Venecias, përfshirë CDL-AD(2015)039, CDL-AD(2005)039, CDL-PI(2015)001; (iii) në nenin 11 (Paneli vlerësues dhe procedura e intervistimit) të saj, Rregullorja përcakton përbërjen e Panelit vlerësues nga pesë (5) anëtarë të KPK-së të zgjedhur me short dhe sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në padi, një zgjidhje e tillë është në kundërshtim me Ligjin për KPK-në, sepse i mundëson pakicës në KPK që t'i propozojë shumicës kandidatin për Kryeprokuror dhe se anëtarët e KPK-së, kanë vetëm mundësinë të votojnë ose kundërshtojnë kandidatin e propozuar nga Paneli vlerësues; (iv) në nenin 16 (Kundërshtimi i kandidatëve ndaj procesit të poentimit) të saj, Rregullorja përcakton që KPK, në përbërje të plotë, voton për propozimin e Komisionit për rishqyrtim, ndërsa pjesëmarrja e anëtarëve të KPK-së që kanë qenë pjesë e Panelit vlerësues në këtë votim, është në kundërshtim me Kushtetutën dhe Ligjin për KPK-në, ndër tjerash, sepse përbën “konflikt interesi”; dhe (v) në nenin 15 (Njoftimi i kandidatëve) të saj, Rregullorja përcakton që njoftimi për kandidatin për Kryeprokuror do të përmbajë poentimin përfundimtar nga të gjithë anëtarët e Panelit Vlerësues të anonimizuar dhe poentimin individual të anonimizuar të dhënë nga secili anëtarë i Panelit vlerësues, bashkë me arsyetimin për secilën kategori poentuese dhe sipas parashtruesit të kërkesës, një përcaktim i tillë është në kundërshtim me “*frymën kushtetuese, procesin e hapur, të drejtë, korrekt, transparent dhe meritore*”, sepse në mungesë të qasjes edhe në dosjet e kandidatëve të tjerë, përkatësisht vlerësimet dhe poentimet e tyre, kandidatit të pakënaqur me vlerësimin, i pamundësohet ushtrimi i mjetit juridik.

34. Për sa i përket mënyrës së poentimit të anëtarëve të Panelit vlerësues të KPK-së, parashtruesi i kërkesës, fillimisht thekson se fakti se nuk ka pasur qasje në vlerësimet dhe poentimet e kandidatëve të tjerë nga ana e Panelit vlerësues, i ka pamundësuar kundërshtimin efektiv të poentimeve të tij sepse nuk ka mundur të konstatojë nëse “*ka ndonjë dallim në vlerësim dhe nëse ka, ku është bazuar ai dallim*”. Për më tepër dhe më saktësisht, parashtruesi i kërkesës kontestonte poentimet e anëtarëve të Panelit vlerësues, të shënuar me kodet 159 FTC, 214 LOD dhe 430 VIK, respektivisht. Përkitazi me të parin, parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, theksoi që lidhur me vlerësimin e (i) kriterit të koncept-dokumentit, ky anëtar e ka vlerësuar me 26 nga 30 pikët e mundshme, por nuk e ka arsyetuar zbritjen përkatëse të pikëve; (ii) kriterit të integritetit, e ka vlerësuar me 18 nga 20 pikët e mundshme, por nuk ka arsyetuar zbritjen përkatëse të pikëve; dhe (iii) kriterit të aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale, ky anëtar i Panelit vlerësues e ka vlerësuar me 25 nga 30 pikët e mundshme, por parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me arsyetimin përkatës lidhur me përvojën e tij menaxheriale. Përkitazi me anëtarin e dytë të Panelit vlerësues, parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, theksoi që lidhur me vlerësimin e (i) kriterit të koncept-dokumentit, ky anëtar e ka vlerësuar me 27 nga 30 pikët e mundshme, por nuk ka arsyetuar zbritjen përkatëse të pikëve; (ii) kriterit të njohurive teknike dhe përvojës, ky anëtar e ka vlerësuar me 18 nga 20 pikët e mundshme, por nuk ka arsyetuar zbritjen përkatëse të pikëve; dhe (iii) kriterit të aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale, e ka vlerësuar me 25 nga 30 pikët e mundshme, por parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me arsyetimin përkatës lidhur me përvojën e tij menaxheriale. Ndërsa, përkitazi me të tretin, parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, theksoi që lidhur me vlerësimin e (i) kriterit të koncept-dokumentit, ky anëtar e ka vlerësuar me 27 nga 30 pikët e mundshme, por parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me arsyetimin e dhënë lidhur me zbritjen përkatëse të pikëve; (ii) kriterit të njohurive teknike dhe përvojës, ky anëtar e ka vlerësuar me 18 nga 20 pikët e mundshme, por parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me arsyetimin e dhënë lidhur me zbritjen përkatëse të pikëve; (iii) kriterit të integritetit, e ka vlerësuar me 18 nga 20 pikët e mundshme, duke e bazuar këtë vlerësimin mbi shqiptimin e një vërejtjeje gjyqësore nga ana e Gjykatës Komonale



në Suharekë, masë kjo e cila sipas parashtruesit të kërkesës, është shlyer dhe se bazuar në paragrafin 4 të nenin 98 (Përmbajtja dhe zbulimi i të dhënave nga dosja penale) të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës, KPK nuk mund të referohet në të dhëna të tilla ngase dënimi në fjalë është shlyer; dhe (iv) kriterit të aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale, ky anëtar e ka vlerësuar me 26 nga 30 pikët e mundshme, por parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me arsyetimin përkatës lidhur me përvojën e tij menaxheriale.

35. Parashtruesi i kërkesës në këtë padi gjithashtu kishte ngritur edhe tri pretendime shtesë. Së pari, se nuk i është dorëzuar Vendimi i KPK-së për propozimin e Kryeprokurorit, dhe për pasojë, *“i është pamundësuar që të iniciojë procedurat ligjore për sfidimin e vendimit në rrugë gjyqësore”*. Së dyti, që Vendimi [KPK.nr.474/2022] i 6 prillit 2022 i KPK-së, për refuzimin e propozimit të Komisionit për rishqyrtim, është nxjerrë *“në shkelje të Ligjit për Procedurë Administrative nr.05/L-031, respektivisht neneve 47, 48 dhe nenit 52, par. 1 pika 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të këtij ligji”*, sepse i njëjti (i) nuk përcakton këshillën juridike në kundërshtim me nenin 125 (Ankesa) të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (në tekstin e mëtejme: LPA) dhe nenin 32 të Kushtetutës; dhe (ii) nuk përmban arsyetim të mjaftueshëm, përkatësisht arsyetimi përkatës është *“dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshënës apo i pakuptueshëm”* në kundërshtim me paragrafin 48 (Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim) të LPA-së. Ndërsa, së treti, që Komunikata e KPK-së e 25 marsit 2022 është në kundërshtim me nenin 1.1 të Rregullores së KPK-së, përkatësisht detyrimin e kësaj të fundit, për një proces objektiv, transparent, jodiskriminues dhe gjithëpërfshirës të bazuar në meritokraci lidhur me procedurën e propozimit për emërim të Kryeprokurorit të Shtetit.
36. Më 2 gusht 2022, Gjykata Themelore nxori Aktvendimin [A. nr. 1875/22], përmes të cilit e hodhi poshtë si të paraqitur pas kalimit të afatit padinë dhe propozimin e parashtruesit për shtyrjen e ekzekutimit dhe anulimin e dy akteve të kontesuara të KPK-së. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata Themelore e trajtoi (i) çështjen e pasafatshmërisë së paraqitjes së propozimit për inicimin e konfliktit administrativ sipas nenit 27 të LKA-së; (ii) aplikueshmërinë e nenit 28 të LKA-së; dhe (iii) aplikueshmërinë e neneve 129 dhe 130 të LPA-së, lidhur me mundësinë e kthimit të gjendjen e mëparshme.
37. Përkitazi me çështjen parë, përkatësisht pasafatshmërisë ligjore të paraqitjes së propozimit për inicimin e konfliktit administrativ, Gjykata Themelore, në esencë, theksoi që (i) bazuar në nenin 27 të LKA-së, padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar, ndërsa në rast që akti administrativ nuk i është dorëzuar, pala mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ; (ii) pala përkatëse, aktet e kontestuara i ka pranuar më 6 prill 2022 dhe rrjedhimisht, afati për paraqitjen e padisë përkatëse ka qenë data 6 maj 2022; dhe (iii) padia përkatëse është parashtruar më 28 korrik 2022, *“përkatësisht 3 muaj e 22 ditë, pas pranimit të akteve të cekura, apo 2 muaj e 22 ditë pas kalimit të afatit ligjor”*.
38. Më saktësisht, Gjykata themelore, ndër tjerash, arsyetoi si në vijim:

*“Gjykata duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse [...] gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, propozimit dhe shkresave tjera të lëndës, vlerësimit të rregullshmërisë së tyre, si dhe afatshmërinë e padisë dhe propozimit të paditësit-propozuesit, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), nenin 26 “Procedura në bazë të padisë” dhe nenit 27 paragrafit 1, ku përcaktohet se: “Padia paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, që nga dita e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës”, ndërsa me par. 2 të këtij*

neni përcaktohet se: “Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar palës, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”.

Gjykata gjeti se pala paditëse-propozuese, vendimet e kontestuara të KPK-së, atë të dt. 06.04.2022 për propozimin e z. B. I. për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Vendimin për Refuzimin e Raportit të Komisionit për Rishqyrtim të KPK-së, nr. 474/2022 të dt. 6 prill 2022, i kishte pranuar, përkatësisht për të njëjtat ishte njoftuar po të njëjtën datë që janë marrë, pra më 06 prill 2022.

Nga ky konstatim, e duke ju referuar dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), nenit 27 paragrafit 1 – të përshkruar më lartë, rezulton se pala paditëse afatin e fundit për të ju drejtuar kësaj Gjykate me padi dhe kërkesat tjera të veta, e kishte deri më dt. 06 maj 2022.

Paditësi në këtë gjykatë ka ushtruar Padi për inicim të Konfliktit Administrativ dhe Propozim për shtyerje të ekzekutimit të akteve të shënuara si më lartë, me datën 28 korrik 2022, përkatësisht 3 muaj e 22 ditë, pas pranimit të akteve të cekura, apo 2 muaj e 22 ditë pas kalimit të afatit ligjor të përcaktuar me nenin 27.1 të LKA, për ushtrim të padisë“.

39. Përkitazi me çështjen e dytë, përkatësisht pretendimin e parashtruesit të kërkesës që padia përkatëse “duhet të konsiderohet se është paraqitur me kohë”, sepse paraqitja e saj në “organin tjetër jo-kompetent”, përkatësisht Gjykatën Kushtetuese, “ka qenë si pasojë e mos dijës apo e gabimit të hapur”, në kontekst të nenit 28 të LKA-së, Gjykata Themelore, në esencë, vuri theks në (i) dallimin në objektin e çështjes; dhe (ii) faktin që padia dorëzuar, sipas pretendimit, “organit jo-kompetent”, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese, nuk është referuar nga e njëjta në Gjykatën Themelore dhe për më tepër që, Gjykata Kushtetuese, ka vendosur përkitazi me kërkesën e parashtruesit të kërkesës. Më saktësisht dhe në kontekst të së parës, Gjykata Themelore, ndër tjerash, theksoi që objekt i çështjes në Gjykatën Kushtetuese ka qenë vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të KPK-së, ndërsa objekt vlerësimi në Gjykatën Themelore është shtyrja e ekzekutimit dhe anulimi i akteve të kontestuara të KPK-së, ndërsa në kontekst të së dytës, ndër tjerash, theksoi që për tu konsideruar e afatshme një kërkesë bazuar në paragrafin 2 të nenit 28 të LKA-së, padia përkatëse duhet të jetë dorëzuar në “organin jo-kompetent” brenda afatit të përcaktuar në nenin 27 të LKA-së dhe që “organi jo-kompetent”, duhet të ketë referuar padinë përkatëse në Gjykatën Themelore.
40. Më saktësisht, Gjykata Themelore, ndër tjerash, arsyetoi si në vijim:

“Për kundër konstatimit të dhënë, nga shkresat tjera të kësaj lënde administrative, përkatësisht nga Aktvendimi për pa pranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese Nr. ref. RK 2027/22 dt. 25 korrik 2022, gjykata gjeti se objekt i çështjes në Kushtetuese ka qenë Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të KPK-së nga 06 prill 2022, kurse këtu paditësi përmes Propozimit dhe Padisë së dorëzuar më dt. 28.07.2022 në Departamentin Administrativ të kësaj Gjykate, kërkon që fillimisht të shtyhet ekzekutimi dhe në fund të procedurës gjykata me vendim të prerë ti anulojë vendimet e cekura të të paditurës, të anulohet në tërësi procesi i intervistimit si kundërkushtetues dhe i kundërligjshëm dhe ti rikthehet KPK-së që nga fillimi procesi i emërimit të Kryeprokurorit.

*Neni 28 i LKA përcakton: "Nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës, por organit tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit".*

*Bazuar në dispozitën e lartpërshtuar, e në rast se Institucioni Kushtetues të cilit paditësi i kishte drejtuar kërkesën e cekur më lartë, të njëjtën do ja dërgonte në kompetencë për procedim kësaj gjykate, do të konsiderohej si kërkesë e afatshme, po që se pala i është drejtuar institucionit brenda afatit të përcaktuar me nenin 27 paragrafit 1 të LKA, edhe po që se në këtë gjykatë kishte me arrij të pas afatit ligjor për Inicim të Konfliktit Administrativ.*

*Në rastin konkret, kur përmbajtja e kërkesës së paditësit dërguar Gjykatës Kushtetuese, ndryshon nga Padia për inicim të Konfliktit Administrativ në këtë gjykatë, e duke marrë parasysh edhe faktin që Gjykata Kushtetuese ka vendosë sipas kërkesës së palës paditëse, gjykata e çështjes e konsideron të pa bazuar kërkesën e kësaj pale, që Padinë dhe Propozimin e drejtuar kësaj gjykate ta konsiderojë të njëjtë me kërkesën që ja kishte Gjykatës Kushtetuese, me qëllim që padia e tij këtu të konsiderohet e ushtruar brenda afatit ligjor".*

41. Ndërsa, përkitazi me çështjen e tretë, përkatësisht kërkesën për kthim në gjendjen e mëparshme, në kontekst të neneve 129 dhe 130 të LPK-së, respektivisht, Gjykata Themelore, ndër tjerash, theksoi që dispozitat e lartcekura ndërlidhen me humbjen e afateve procedurale, për shkaqe të arsyeshme dhe të cilat nuk kanë mundur të parashikohen dhe as të evitohen përgjatë një procesi kontestimor dhe nuk ndërlidhet me afatin për paraqitjen e padisë dhe/ose inicimit të konfliktit administrativ, siç është rasti në rrethanat e rastit konkret.
42. Më saktësisht, Gjykata Themelore, ndër tjerash, arsyetoi si në vijim:

*"[...] edhe kërkesa për kthim në gjendje të mëparëshme nuk i përgjigjet rasteve të përcaktuara me dispozitat e nenit 129 dhe 130 të LPK-së – Ligji 03/L-006, pasi që kthimi në gjendjen e mëparëshme bëhet në rastet kur për një çështje ligjore veç se është filluar procedimi gjyqësor, gjat të cilit ndonjëra nga palët pjesëmarrëse për shkaqe të justifikueshme ka humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural.*

*Në çështjen konkrete, në këtë gjykatë nga pala paditëse është realizuar vetëm veprimi i dorëzimit të padisë me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të KPK-së dhe se ende nga gjykata nuk është ftuar ndonjëra nga palët që të ndërmerr ndonjë veprim procedural të lidhur me ndonjë afat ligjor apo gjyqësor.*

*Duke e marrë për bazë faktin që me datën 06 prill 2022, paditësi veç tjerash edhe përmes mjeteve të informimit publik, u njoftua për vendimin e të paditurës të dt. 06.04.2022, për propozim të Z. Blerim Isufaj për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe vendimin për Refuzim të Raportit të Komisionit për Rishqyrtim, nr. 474/2022 dt. 06.04.2022, kurse Padinë për inicim të konfliktit administrativ, së bashku me Propozim për shtyrje të zbatimit të vendimeve të kontestuara, e dorëzoi në gjykatë më dt. 28.07.2022, përkatësisht 2 muaj e 22 ditë pas kalimit të afatit ligjor, e po ashtu nga konstatimet si më lartë, se për çfarë arsye padia dhe propozimi i paditësit nuk mund të konsiderohen të afatshme, duke dhënë edhe arsyet se pse në këtë rast veprimet e lëshuara nuk mund të kthehen në gjendjen e para mos veprimi, bazuar në dispozitat e cekura më lartë, rezulton se padia e paditësit është ushtruar jashtë afatit të përcaktuar ligjor".*

43. Më 12 gusht 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit [A.nr.1875/22] të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje të dispozitave të procedurës administrative, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Në esencë, parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, pretendoi që (i) objekti i çështjes para Gjykatës Kushtetuese përmes kërkesës për vlerësim të kushtetutshmërisë dhe i asaj para Gjykatës Themelore përmes kërkesëpadisë dhe kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, është i njëjtë sepse në të dyja rastet, kontestohen aktet përkatëse të KPK-së; (ii) Gjykata Themelore gabimisht ka interpretuar nenin 28 të LKA-së, bazuar në të cilin, nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës, por "*organit tjetër jo-kompetent*", ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e "*mos dijës apo e gabimit të hapur*" të paraqitësit, sepse parashtruesi ka dorëzuar kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së në Gjykatën Kushtetuese, duke u bazuar në vendimmarrjen e saj në rastet KI99/14 dhe KI100/14, me parashtrues *Shyqyri Sylja dhe Laura Pula*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI99/14 dhe KI100/14), KI34/17, dhe KI55/17, me parashtruese *Tonka Berisha*, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit KGJ nr. 13/2017, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 13 janarit 2017 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI55/17); prandaj, pretendon se dorëzimi i kërkesës në Gjykatën Kushtetuese, e që për rrjedhojë, i ka shkaktuar humbjen e afatit për paraqitjen e padisë në Gjykatën Themelore, duhet të konsiderohet si "*gabim i hapur*" i tij, për qëllime të nenit 28 të LKA-së dhe rrjedhimisht, padia të konsiderohet e afatshme, pa marrë parasysh faktin që Gjykata Kushtetuese nuk e ka dorëzuar/referuar kërkesën e tij në Gjykatën Themelore, sepse Gjykata Kushtetuese nuk e ka një kompetencë të tillë; dhe (iii) Gjykata Themelore gabimisht ka interpretuar nenin 129 të LPK-së, bazuar në të cilin, ndër tjerash, në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural, gjykata përkatëse mund t'i lejojë kthimin në gjendje të mëparshme, sepse kjo dispozitë nuk mund të aplikohet vetëm lidhur me veprimet procedurale në rastet në procedim e sipër, por përfshin gjithashtu humbjen e çfarëdo afati procedural, përfshirë afatin për paraqitjen e padisë për inicimin e konfliktit administrativ. Në kontekst të pretendimeve të lartcekura, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendoi shkeljen e të drejtës së tij kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, sipas garancive të përcaktuara me nenin 31 të Kushtetutës.
44. Më 1 shtator 2022, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin [AA. nr. 650/2022], përmes të cilit refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi në tërësi Aktvendimin [A. nr. 1875/2022] e Gjykatës Themelore.
45. Gjykata e Apelit, ndër tjerash, kishte theksuar që (i) padia në Gjykatën Themelore ishte dorëzuar pas afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar në nenin 27 të LKA-së, sepse pala paditëse, aktet e kontestuara, i ka pranuar më 6 prill 2022, ndërsa padinë në Gjykatën Themelore e ka parashtruar më 28 korrik 2022; (ii) neni 28 i LKA-së, bazuar në të cilin paditësi pretendon që padia duhet të konsiderohet si e afatshme, sepse si rezultat i "*mos dijës apo gabimit të hapur*", padia përkatëse është dorëzuar në "*organin jo-kompetent*", përkatësisht në Gjykatën Kushtetuese, nuk është i aplikueshëm, sepse rendi juridik në Republikën e Kosovës është i ndërtuar mbi bazën e ligjeve dhe jo pretendimeve mbi precedentin dhe se bazuar në ligjet e aplikueshme, është Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë që ka kompetencën ekskluzive për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative nga ana e organeve administrative; dhe (iii) nenet

129 dhe 130 të LPK-së, respektivisht, janë të aplikueshme në rrethanat në të cilat procesi gjyqësor ka filluar dhe se kthimi në gjendje të mëparshme lejohet lidhur me veprimet procedurale përkatëse gjatë procesit, nëse afatet për kryerjen e të njëjtave janë humbur për shkaqe që gjykata përkatëse i vlerëson të arsyeshme, por jo edhe për humbjen e afatit për paraqitjen e padisë fillestare.

46. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata e Apelit, ndër tjerash, theksoi:

*“Kolegji i Gjykatës së Apelit, si Gjykata e shkallës së parë, vlerëson se paditësi kundër vendimeve të kontestuara me padi, KPK. Nr. 457/2022 të datës 06.04.2022, me datë 28 prill 2002, kishte ushtruar kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, por jo edhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e cila me aktvendimin e saj me Nr. ref.: RK 2027/22 të datës 25 korrik 2022, ka vendosur për papranueshmëri të kërkesës së paditësit etj. Kurse paditësi pas pranimit të aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, më datë 28 korrik 2022, ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, duke lëshuar kështu afatin prej tridhjetë (30) ditësh, për të ushtruar padi në Gjykatë, ashtu siç kërkohet me nenin 27 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili nen përcakton se “I. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës”. Ndërsa në paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se “Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti”.*

*Lidhur me pretendimin nga ankesa e paditësit se “Paditësi ka argumentuar se deri te data e ushtrimit të padisë ekziston gabimi i hapur i paraqitësit në drejtimin e padisë në organin jo kompetent dhe shkaku i arsyeshëm që nuk ka mund të parashikohet e as të evitohet, se janë krijuar praktika të atilla që lidhur me kërkesat për kandidatë të Kryeprokurorit të Kosovës që fillimisht do të duhej drejtueshin Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, vendosë Gjykata Kushtetuese, pa u iniciuar paraprakisht rasti në gjykatën kompetente. Provë: Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, KI110/14; KI34/17; si dhe KI55/17...”, të njëjtin pretendim kolegji i apelit e vlerëson si të pa bazuar, për faktin se paditësi nuk mund të thirret në gabimin e hapur të tij në drejtimin e padisë në organin jo kompetent, duke u bazuar në tri raste kur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e ka marrë kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, për të vlerësuar aktet përfundimtare të nxjerra nga ana e organeve administrative, kjo për faktin se paditësi dhe autorizuari i tij kanë arsimim të duhur ligjor, dhe se kanë qenë dashur të dinë se rendi juridik në Republikën e Kosovës, është ndërtuar mbi bazën e ligjeve e jo të precedentit gjyqësor, dhe se sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka kompetencë ekskluzive për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative nga ana e organeve administrative, e jo të ndiqet precedenti gjyqësor, i krijuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës me tri raste, dhe në këtë kuptim ky pretendim i paditësit është i pa qëndrueshëm, e rrjedhimisht edhe i pa bazuar.*

*Ndërsa lidhur me pretendimin e paditësit se “Kthimi në gjendjen e mëparshme është institut që vlen vetëm për rastet kur është në procedim një çështje juridike.*

*E konsiderojmë të pa pranueshëm këtë pretendim të Gjykatës së shkallës së parë [...].*

*Kolegji i apelit e vlerëson si të pa bazuar të njëjtin pretendim për faktin se kërkesa e paditësit për kthim në gjendjen e mëparshme, përkatësisht të konsiderohet se padia e paditësit është paraqitur me kohe në Gjykatë, nuk i referohet rasteve të përcaktuara me dispozitat e nenit 129 dhe 130 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ngase kthimi në gjendjen e mëparshme, lejohet në rastet kur për një çështje gjyqësore veç se është filluar, përkatësisht është duke u zhvilluar procedura gjyqësore, gjatë të cilës ndonjëra nga palët për shkaqe të arsyeshme ka humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural. Kurse në rastin e paditësit, në Gjykatën e shkallës së parë është bërë vetëm veprimi i dorëzimit të padisë me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të KPK-së, dhe se nga Gjykata nuk është ftuar ndonjëra nga palët që të ndërmerret ndonjë veprim procedural, i cili do të lidhet me ndonjë afat ligjor apo gjyqësor, e i cili afat në rast se do të lëshohet nga palët për të kryer ndonjë veprim të urdhëruar nga Gjykata, atëherë do të aplikohet instituti i kthimit në gjendjen e mëparshme, por jo edhe siç pretendon paditësi”.*

47. *Më 20 tetor 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Supreme kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të Aktvendimit [AA.nr.650/2022] të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar shkelje të së drejtës materiale, si dhe shkelje të dispozitave ligjore. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës, para Gjykatës Supreme pretendon shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, duke përsëritur në esencë pretendimet e ngritura në Gjykatën e Apelit, dhe duke theksuar faktin që Gjykata e Apelit, në mënyrë të gabuar ka interpretuar ligjin e aplikueshëm, me theks në (i) nenin 28 të LKA-së, përkitazi me mundësinë që një padi të konsiderohet e afatshme nëse është dorëzuar në “organin jo-kompetent” si rezultat i “mos dijës apo gabimit të hapur”, duke theksuar që shkak për këtë ishte praktika gjyqësore paraprake e Gjykatës Kushtetuese, në rastet KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17 dhe KI55/17; dhe (ii) nenin 129 të LPK-së, lidhur me mundësinë e kthimit në gjendje të mëparshme, institut i cili sipas pretendimit përkatës, nuk mund të interpretohet të jetë i aplikueshëm vetëm për veprimet procedurale lidhur me rastet në proces, por përfshinë edhe afatin për paraqitjen e padisë për inicimin e konfliktit administrativ. Në këtë kontekst dhe ndër tjerash, parashtruesi i kërkesës gjithashtu kishte theksuar që “(...) gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë vepruar në kundërshtim me nenin 4 të LKA-së apo parimin e Ligjshmërisë, ngase nuk kanë vepruar në bazë të ndërlidhjes së nenit 28 të LKA-së, me nenin 31.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke zbatuar vetëm në mënyrë sipërfaqësore ligjin, apo konkretisht nenin 28 të LKA-së, e jo në tërësinë dhe frymën e tij, pasi ligji duhet gjithmonë të jetë në frymën kushtetuese, kurse fryma kushtetuese nuk i përgjigjet drejtë mohimit të palës për të shqyrtuar kërkesën e tij pranë gjykatës së themeluar me ligj në Kosovë, për shkak të një gabimi të hapur të tij, përkundrazi, fryma kushtetuese i përgjigjet drejtë mbrojtjes gjyqësore të palës dhe aprovimit të shqyrtimit verbal e publik të kërkesës së tij.”*
48. *Më 23 dhjetor 2022, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [ARJ. nr. 114/2022], përmes të cilit refuzoi si të pabazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paraqitur kundër Aktvendimit [AA. nr. 650/2022] të Gjykatës së Apelit.*
49. *Në arsyetimin e saj, Gjykata Supreme, ndër tjerash, theksoi që (i) neni 28 i LKA-së, nuk është i aplikueshëm në rrethanat e rastit konkret, sepse dorëzimi i kërkesës së parashtruesit të kërkesës fillimisht në Gjykatën Kushtetuese, nuk është si rezultat i “mos dijës apo gabimit të hapur”, marrë parasysh që i njëjti, në Gjykatën Kushtetuese kishte dorëzuar kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së, pa i shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj, përkatësisht me LKA; (ii)*

padia e palës përkatëse nuk ka arritur në Gjykatën Themelore pas afatit, por është parashtruar pas afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar në LKA; dhe (iii) neni 129 i LPK-së, përkitazi me mundësinë e kthimit në gjendje të mëparshme, është i aplikueshëm përkitazi me humbjen e afateve procedurale pas paraqitjes së padisë dhe nuk u saktëson kompetencën gjykatave të rregullta për të rivendosur afate ligjore të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm, siç është rasti me afatet për paraqitjen e padisë për iniciimin e konfliktit administrativ sipas nenit 27 të LKA-së.

50. Në arsyetimin e Aktvendimit të saj, Gjykata Supreme, ndër tjerash, theksoi:

*"[...] nuk janë të qëndrueshme theksimet e tjera të cekura si më lartë se nga gjykatat më të ulëta është dashtë të aplikohet neni 28 i LKA me që kërkesën e ka dërguar në Gjykatë Kushtetuese brenda afatit prej 30 ditë për tu vlerësuar kushtetutshmëria e vendimeve të organit të paditur duke u bazuar në precedentë të krijuara nga ajo, sepse Gjykata Kushtetuese me aktvendimin e saj Nr. ref. RK. 2027/22 të dt. 25.07.2022, sipas kërkesës së parashtruar lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të organit të paditur e ka refuzuar si të pa pranueshme dhe pas kësaj paditësi me datë 28 Korrik 2022 ushtron padi në Gjykatë Themelore në konflikt administrativ. Nga këto fakte rezulton se padia nuk është dorëzuar gabimisht në organin tjetër por i është drejtuar dhe dorëzuar si kërkesë Gjykatës Kushtetuese, për vlerësim të kushtetutshmërisë së vendimeve të organit të paditur KPK.*

*Kjo kërkesë nuk ka arritur në gjykatën e shkallës së parë pas afatit dhe e pa shqyrtuar për tu nxënë afati si pretendon paditësi dhe për tu trajtuar si padi e po ashtu nuk mund të thirret në fakte se nuk e ka ditur apo se gabimisht e ka paraqitur në Gjykatë Kushtetuese, gjer sa kërkesa i është drejtuar asaj gjykate, pa i shtjerrë mjetet juridike në procedurë të rregullt gjyqësore të konfliktit administrativ me padi për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve përfundimtare administrative, ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LKA-së.*

Sa i përket kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme, Gjykata Supreme ka marrë qëndrimin si në vijim:

*"Pretendimet e tjera si në kërkesë lidhur me rikthimin në gjendjen e më parme [...] po ashtu nuk janë të qëndrueshme, sepse në këtë rast gjykatat e themeluara sipas Ligjit për Gjykatat nuk janë kompetente të rivendosin një afat ligjor prekluziv të humbur nga vetë pala paditëse i cili nuk ka vepruar ashtu si parashihet me ligj për të paraqitur padi në Gjykatë Themelore në Procedurë të Konfliktit Administrativ në afatin e lejuar ligjor. Sipas nenit 129 të LPA përcaktohet rivendosja e afateve por vetëm pas fillimit të veprimeve procedurale pas paraqitjes së padisë e tutje, nëse pala nuk shkon në seancë apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural. Sipas kësaj dispozite rregullohet kthimi i gjendjes së më parme esencialisht që palës ti lejohet të ndërmarrë ndonjë veprim procedural të cilin nuk e ka ndërmarrë brenda afatit të caktuar ose që palës ti lejohet të marrë pjesë prapë në seancë të re në se ka arsye të bazuara për humbjen e afatit për ndonjë veprim procedural, ligjor apo gjyqësor".*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

51. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] dhe nenin 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] në lidhje me nenin 6 (E drejta për një

proces të rregullt) dhe nenin 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe atyre të përcaktuara me nenin 10 (pa titull) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, ndërsa shtjellon dhe paraqet argumentet përkatëse vetëm lidhur me pretendimet përkitazi me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe me shkeljen e nenit 54 të Kushtetutës.

52. Parashtruesi i kërkesës pretendon se kërkesa e tij është e pranueshme bazuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, sepse (i) është person fizik që i janë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë; (ii) shkeljet kushtetuese janë bërë nga një autoritet publik, përkatësisht nga tri shkallët gjyqësore *“me mohimin e qasjes së tij në drejtësi, përmes mohimit të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe mohimit të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave, që e bëjnë të qartë se kemi të bëjmë me një autoritet publik”*; (iii) i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; (iv) ka saktësuar qartë dispozitat kushtetuese dhe të drejtat e garantuara që pretendon t'i jenë shkelur; dhe (v) kërkesën e ka paraqitur brenda afatit ligjor prej katër (4) muajsh, në përputhje me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon mbajtjen e seancës dëgjimore në rastin e tij.
53. Parashtruesi i kërkesës, në esencë, pretendon që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është nxjerrë në kundërshtim me garancitë kushtetuese të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës pretendon që përmes vendimmarrjes (i) së Gjykatës Kushtetuese në rastin KI57/22 dhe KI79/22, përmes të cilit është refuzuar kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së si pasojë e mosshterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj; dhe (ii) gjykatave të rregullta, përmes të cilave është refuzuar padia lidhur me aktet e kontestuara të KPK-së si pasojë e pasafatshmërisë së padisë, është cenuar e drejta e tij për qasje në drejtësi, e garantuar me nenet e lartcekura të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.
54. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës fillimisht pretendon që kërkesa e tij në Gjykatën Kushtetutës, pa i shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj, është dorëzuar bazuar në praktikën paraprake të kësaj Gjykatës sipas rasteve KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17, si dhe KI55/17. Sipas parashtruesit të kërkesës, ndër tjerash, vendimet e lartcekura të Gjykatës Kushtetuese, ishin *“shëndërruar tashmë në normë ligjore”* dhe për pasojë, parashtruesi i kërkesës kishte pritje të arsyeshme që Gjykata Kushtetuese do të trajtonte edhe kërkesën e tij për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së në merita. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon që kërkesa në Gjykatën Kushtetuese ishte dorëzuar brenda afatit tridhjetë (30) ditore për iniciimin e konfliktit administrativ, të përcaktuar në nenin 27 të LKA-së, ndërsa Gjykata Kushtetuese *“nuk morri vendim edhe 3 muaj pas pranimit të kërkesës së saj”* dhe *“gjatë gjithë kësaj kohe, Gjykata Kushtetuese nuk e dërgoi lëndën në gjykatat e rregullta...”*. Si rrjedhojë, parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, *“i kërkon Gjykatës Kushtetuese të përmirësojë gabimin e saj dhe të gjykatave të rregullta dhe të konstatoj se parashtruesit të kërkesës, nga të gjitha gjykatat e rregullta, i është mohuar qasja në drejtësi dhe i është mohuar e drejta themelore e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me KEDNJ-në (...)*”.
55. Për më tepër dhe në kontekst të vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese në rastin KI57/22 dhe KI79/22, ndër tjerash, parashtruesi i kërkesës thekson që (i) e njëjta në tri raste paraprake, përkatësisht KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17, si dhe KI55/17, kishte vendosur në merita, përfshirë lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryetarit të Gjykatës Supreme; (ii) në kontekst të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit që *“Aleksandër Lumezi ishte zgjedhur dhe ishte dekretuar për Kryeprokuror të Shtetit me dt.21.04.2014. Dekretimit të tij i kishin paraprirë ankesat e Shyqri Sylës dhe Laura Pulës. Atëbotë, Gjykata Kushtetuese*



*kishte vendos në mënyrë meritore rreth rasteve*"; dhe (iii) *"mes rastit të Laura Pulës dhe Shyqri Sylës nga njëra anë dhe Shqipdon Fazliut në anën tjetër nuk ekziston asnjë dallim, përpos dallimit në trajtim nga ana e Gjykatës Kushtetuese"*; dhe (iv) *"ndryshimi i precedentit, megjithatë, në asnjë rrethanë nuk është dashur të rezultojë në mohimin e qasjes në drejtësi për parashtruesin nga ana e gjykatave të rregullta"*.

56. Më tej, parashtruesi i kërkesës, sqaron që pas vendimmarrjes nga Gjykata Kushtetuese në rastin KI57/22 dhe KI79/22, i njëjti i është drejtuar Gjykatës Themelore përmes inicimit të konfliktit administrativ me padi, duke pretenduar, ndër tjerash, që padia e tij në Gjykatën Themelore, bazuar mbi dispozitat e ligjit të aplikueshëm, duhet të trajtohet si e afatshme, përkatësisht bazuar në (i) nenin 28 të LKA-së, sipas të cilit, padia e tij do të duhej të konsiderohej si e afatshme sepse si pasojë e *"mos dijës apo gabimit të hapur"*, përkatësisht praktikës paraprake gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kërkesa për vlerësimin e akteve të kontestuara të KPK-së, i është dorëzuar *"organit jo-kompetent"*, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese; dhe (ii) nenet 129 dhe 130 të LPK-së, sipas të cilave, nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen, gjykata përkatëse mund të lejojë kthimin në gjendjen e mëparshme për kryerjen e ndonjë veprimi procedural. Parashtruesi i kërkesës, pretendon që konstatimi i gjykatave të rregullta që padia e tij e dorëzuar në Gjykatën Themelore është e pasaaftshme bazuar në nenin 27 të LKA-së dhe që nenet 28 të LKA-së dhe 129 dhe 130 të LPK-së, respektivisht, nuk janë të aplikueshme në rrethanat e rastit të tij, rezulton në cenim të së drejtës së tij për qasje në drejtësi, të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
57. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës, pretendon që gjykatat e rregullta kanë interpretuar dispozitat përkatëse të LKA-së dhe LPK-së, në mënyrë të gabuar dhe arbitrare, ndër tjerash, sepse të njëjtat (i) kanë zbatuar gabimisht nenin 27 të LKA-së, sipas të cilit padia duhet të dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh, në vend të nenit 28 të LKA-së, sipas të cilit, padia do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse e njëjta i është paraqitur *"organit jo-kompetent"* si rezultat i *"mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit"*, nën ky që, sipas pretendimit, duhet të interpretohet në përputhje me nenin 4 (Parimi i ligjshmërisë) të LKA-së, përkatësisht detyrimin e gjykatave që në raste të konfliktit administrativ të vendosin në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve; (ii) duhet të kenë marrë parasysh që referenca në praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në rastet KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17, si dhe KI55/17, *"pavarësisht që precedenti ka rol dytësor, kur ka ngjashmëri substanciale me vendimet paraprake, merret për bazë precedenti si i tillë, e sidomos kur bëhet fjalë për vendime të Gjykatës Kushtetuese"*, mbi bazën e të cilës ai i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese dhe jo Gjykatës Themelore, përbën bazë të *"mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit"* dhe rrjedhimisht, përcakton aplikueshmërinë e nenit 28 të LKA-së; (iii) arsyetimi i gjykatave të rregullta, përkatësisht i Gjykatës së Apelit, që *"paditësi nuk mund të thirret në gabimin e hapur të tij në drejtimin e padisë në organin jokompetent, duke u bazuar në tri raste kur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e ka marrë kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departmentit për Çështje Administrative, për të vlerësuar aktet përfundimtare të nxjerra nga ana e organeve administrative"*, ndër tjerash sepse *"sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departmenti për Çështje Administrative, ka kompetencë ekskluzive për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative"*, është shtjellim *"i panevojshëm, i palogjikshëm, absurd, pothuaj anormal (...)"* dhe *"në kundërshtim me interpretimin e drejtë dhe logjik të normës"*; (iv) kanë zbatuar gabimisht nenin 129 të LPK-së, sipas të cilit gjykata përkatëse mund të lejojë palën të kryej veprimin procedural pas afatit nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, sepse gjykatat e rregullta e kanë interpretuar aplikueshmërinë e kësaj dispozite vetëm përkitazi me veprimet procedurale gjatë

shqyrtimit të një çështjeje, përkatësisht pas inicimit të konfliktit administrativ, duke u thirrur edhe në praktikën e tyre gjyqësore, ndërsa, neni 129 i LKP-së, përfshirë në frymën e garancive kushtetuese, përfshinë edhe mundësinë e kthimit të afatit për paraqitjen e padisë për inicimin e konfliktit administrativ, përkatësisht afatin për dorëzimin e padisë. Parashtruesi i kërkesës, ndër tjerash, gjithashtu thekson që *“është në dorën e Gjykatës Kushtetuese të evitohet vendimet sipërfaqësore, të varfra profesionalisht dhe të paqëndrueshme juridikisht dhe të mos lejoj që një qytetar i këtij vendi, padrejtësisht dhe krejtësisht në mënyrë arbitrare të privohet nga qasja në drejtësi”*.

58. Në të njëjtin kontekst, parashtruesi i kërkesës pretendon që i janë shkelur edhe të drejtat e garantuara lidhur me mjetin efektiv juridik dhe mbrojtje gjyqësore të të drejtave sipas përcaktimeve të neneve 32 dhe 54 të Kushtetutës respektivisht, duke theksuar, ndër tjerash, që *“neni 54 i Kushtetutës përmban dispozitën e cila i garanton çdo individit edhe të drejtën për masa efektive juridike, nëse konstatohet se e drejta i është shkelur. Nga kjo del se secilit i është garantuar e drejta për gjykim të pavarur, të paanshëm dhe të bazuar në ligj, që do të thotë se në këtë mënyrë është garantuar e drejta për gjykim të drejtë (neni 31 i Kushtetutës) dhe e drejta për mbrojtje të barabartë pranë gjykatave, në organeve e tjera shtetërore, bartësit e autorizimeve publike dhe organet e njësisve të vetëqeverisjes lokale (neni 24.paragrafi 1. dhe neni 32. i Kushtetutës”*.
59. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që kërkesën e tij (i) ta deklarojë të pranueshme; (ii) të konstatojë që Aktgjykimi [ARJ.nr.114/2022] i Gjykatës Supreme i 23 dhjetorit 2022, në ndërlidhje me Aktvendimin [AA. nr. 650/2022] e Gjykatës së Apelit të 1 shtatorit 2022 dhe Aktvendimin e [A. nr. 1875/22] Gjykatës Themelore të 2 gushtit 2022, janë nxjerrë në shkelje të neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës në lidhje me nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt) dhe 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe nenin 10 (pa titull) të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut; (iii) të shpallë të pavlefshme të njëjtat; dhe (iv) të kthej rastin gjykatën e shkallës së parë për vendosje meritorë.

## **Dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 24 [Barazia para Ligjit]**

*“1. Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim.*

*2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*

*3. Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”*.

#### **Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]**

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.  
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.*

**Neni 32**  
**[E Drejta për Mjete Juridike]**

*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.*

**Neni 54**  
**[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]**

*“Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.*

**Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut**

**Neni 6**  
**(E drejta për një proces të rregullt)**

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë”.*

*[...]*

**Neni 13**  
**(E drejta për zgjidhje efektive)**

*“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*

**DEKLARATA UNIVERSALE PËR TË DREJTAT E NJERIUT**

**Neni 10**

*Secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik para një gjykate të paanshme e të pavarur që do të vendosë për të drejtat dhe detyrimet e tij dhe për mbështetshmërinë e çdo akuze penale kundër tij.*

## **Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative**

*Neni 27  
(Pa titull)*

- 1. Padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës.*
- 2. Ky afat aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, mund të paraqesë padinë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti.*

*Neni 28  
(Pa titull)*

- 1. Padia i dorëzohet gjykatës drejtpërsëdrejti ose i dërgohet me postë rekomandë. Padia mund të bëhet edhe në proces verbal në gjykatë. Dita e paraqitjes së padisë në postë rekomande, respektivisht dita e deklarimit të padisë në procesverbal, konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar gjykatës.*
- 2. Nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës, por organit tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit.*

## **Ligji Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore**

### **KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME**

*Neni 129  
(Pa titull)*

*129.1 Ne qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen.*

*129.2 Kur lejohet kthimi në gjendje të mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit.*

*Neni 130  
(Pa titull)*

- 130.1 Propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer.*
- 130.2 Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkakun e mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin.*
- 130.3 Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.*

130.4 Po që se kthimi në gjendje të mëparshme kërkohet për shkak të mos ruajtjes së afatit për kryerjen e veprimit procedural, propozuesi ka për detyrë që propozimit t'ia bashkëngjisë veprimin e shkruar procedural të pakryer me kohë.

### Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

60. Gjykata fillimisht shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.

61. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

[...]

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

[...]

62. Gjithashtu, Gjykata i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilat përcaktojnë:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Neni 49  
(Afatet)

*“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”.*

63. Sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se: (i) parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar në kuptim të nenit 113.7 të Kushtetutës; (ii) ai konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [ARJ.nr.114/2022] e 23 dhjetorit 2022 të Gjykatës Supreme; (iii) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.;(iv) ka specifikuar qartë të drejtat dhe liritë që ai pretendon se i

janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 (Saktësimi i kërkesës) të Ligjit; dhe (v) kërkesën e ka dorëzuar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 (Afatet) të Ligjit.

64. Përveç kësaj, Gjykata, gjithashtu, shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës, që përcakton:

*“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, kur parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj.”*

65. Duke pasur parasysh pretendimet e parashtrueses së kërkesës dhe argumentimit të tyre, Gjykata konsideron se kërkesa ngre çështje serioze kushtetuese dhe përcaktimi i tyre varet nga shqyrtimi i meritave të kërkesës. Po ashtu, kërkesa nuk mund të konsiderohet si qartazi e pabazuar brenda kuptimit të rregullit 39 të Rregullores së punës dhe nuk është krijuar asnjë bazë tjetër për ta shpallur atë të papranueshme (shih Gjykata Kushtetuese Rasti nr. KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017).

66. Gjykata shpall kërkesën të pranueshme për shqyrtim në merita.

### **Meritat e kërkesës**

67. Gjykata, fillimisht rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, përmes konkursit të shpallur më 14 janar 2022, si pasojë e të cilit, KPK kishte votuar dhe propozuar kandidatin Blerim Isufaj për Kryeprokuror të Shtetit për emërim nga Presidentja e Republikës së Kosovës. Parashtruesi i kërkesës, kishte kontestuar vlerësimin e Panelit vlerësues, sipas të cilit i njëjti ishte radhitur i dyti. Duke marrë parasysh nenin 17 (Procesi i votimit) të Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit, sipas të cilit nëse dallimi në poentim në mes të kandidatit të parë dhe të dytë sipas propozimit të Panelit vlerësues është më shumë se 3%, vetëm kandidati i radhitur si i pari, i nënshtrohet procesit të votimit nga KPK. Siç është sqaruar në faktet e rastit, parashtruesi i kërkesës fillimisht i ishte drejtuar Komisionit për rishqyrtim brenda KPK-së dhe i cili kishte shqyrtuar pretendimet e tij, duke (i) refuzuar si të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me moszbatim të Ligjit për KPK-në dhe Rregullores për Emërimin e Kryeprokurorit; por duke (ii) rekomanduar që pjesërisht të miratohen kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, vetëm sa i përket pretendimit për poentim, me propozimin që anëtarët e Panelit vlerësues të rishikojnë edhe një herë procesin rreth arsytimit të poentimit përkatës. Më 6 prill 2022, KPK kishte nxjerrë dy aktet e kontestuara, përkatësisht (i) Vendimin [Nr.474/2022] e KPK-së për refuzimin e Raportit të Komisionit për rishqyrtim; dhe (ii) Vendimin [KPK/Nr.475/2022] e KPK-së për propozimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit. Këto dy vendime parashtruesi i kërkesës i kishte kontestuar më 28 prill 2022 në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit, më 4 korrik 2022, kishte vendosur se kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme për shqyrtim në merita për arsye procedurale, përkatësisht sepse kërkesa e parashtruar nuk plotësonte kriterin e shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara përmes paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës, duke publikuar komunikatën përkatëse lidhur me vendimmarrjen e saj në të njëjtën ditë, ndërsa, më 26 korrik 2022, Aktvendimi për papranueshmëri në rastet e bashkuara KI57/22 dhe KI79/22, iu dorëzua parashtruesve të kërkesave përkatëse si dhe u publikua në Gazetën Zyrtare dhe në uebfaqen e Gjykatës.

68. Më 28 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës paraqiti në Gjykatën Themelore padi për iniciimin e konfliktit administrativ me propozimin për caktimin e sigurimit të kërkesëpadsisë me masën e përkohshme, përkatësisht kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të akteve të kontestuara të KPK-së për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit. Gjykata Themelore, refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pasafatshme, bazuar në nenin 27 të LKA-së, ndërsa kishte sqaruar dhe përjashtuar aplikueshmërinë e nenit 28 të LKA-së dhe neneve 129 dhe 130 të LPK-së, sipas të cilave parashtruesi i kërkesës pretendonte që padia e tij në Gjykatën Themelore do të duhej të konsiderohej e afatshme. Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme, respektivisht, kishin refuzuar ankesën dhe kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, duke konfirmuar vendimmarrjen e Gjykatës Themelore.
69. Para Gjykatës, parashtruesi i kërkesës, konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, përmes të cilit është konfirmuar vendimmarrja e gjykatave më të ulëta lidhur me pasafatshmërinë e padsisë në konflikt administrativ, duke pretenduar që i njëjti është nxjerrë, në esencë, në shkelje të së drejtës të tij për qasje në drejtësi, sipas garancive të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Siç është sqaruar detajisht, në pjesën që ndërlidhet me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, i njëjti, në esencë, ngre pretendime që ndërlidhen me (i) faktin që kërkesa e tij në Gjykatën Kushtetutës, pa i shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj, është dorëzuar bazuar në praktikën paraprake të kësaj Gjykatës sipas rasteve KI99/14 dhe KI100/14, KI34/17, si dhe KI55/17; (ii) faktin që kërkesa në Gjykatën Kushtetuese është dorëzuar brenda afatit tridhjetë (30) ditorë për iniciimin e konfliktit administrativ të përcaktuar në nenin 27 të LKA-së, ndërsa dhe ndër tjerash, Gjykata Kushtetuese, *“nuk morri vendim edhe 3 muaj pas pranimit të kërkesës së saj”* dhe *“gjatë gjithë kësaj kohe, Gjykata Kushtetuese nuk e dërgoi lëndën në gjykatat e rregullta...”*; dhe (iii) menjëherë pas vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese, i njëjti i është drejtuar Gjykatës Themelore, duke pretenduar që kërkesa e tij duhej të konsiderohej e afatshme sepse bazuar në nenin 28 të LKA-së, si pasojë e *“mos dijës apo gabimit të hapur”*, përkatësisht praktikës paraprake gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, kërkesa për vlerësimin e akteve të kontestuara të KPK-së, i është dorëzuar *“organit jo-kompetent”*, përkatësisht Gjykatës Kushtetuese, ndërsa bazuar në nenet 129 dhe 130 të LPK-së, për shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen, pa marrë parasysh që padia është dorëzuar pas afatit të përcaktuar në LKA, gjykata përkatëse mund të lejojë kthimin në gjendjen e mëparshme për kryerjen e veprimet procedural, përkatësisht iniciimin e konfliktit administrativ. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës, pretendon që gjykatat e rregullta, kanë interpretuar dispozitat përkatëse të LKA-së dhe LPK-së, në mënyrë të gabuar dhe arbitrare, duke rezultuar në cenimin e të drejtës së tij për qasje në drejtësi, dhe për pasojë, kërkon nga Gjykata Kushtetuese, që (i) të konstatojë që Aktgjykimi [ARJ. nr. 114/2022] i Gjykatës Supreme i datës 23 dhjetor 2022, në ndërlidhje me Aktvendimin [AA. nr. 650/2022] të Gjykatës së Apelit të 1 shtatorit 2022 dhe [A. nr. 1875/22] të 2 gushtit 2022, janë nxjerrë në shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së; dhe (ii) të kthej rastin në gjykatën e shkallës së parë, përkatësisht Gjykatën Themelore, për rivendosje.
70. Gjykata, në vijim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, fillimisht thekson që për dallim nga rasti KI57/22 dhe 79/22, përmes të cilit është kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së, në rrethanat e rastit konkret, para Gjykatës kontestohet vendimmarrja e gjykatave të rregullta, përmes të cilave konflikti administrativ i iniciuar kundër akteve të kontestuara të KPK-së është refuzuar si i pasafatshëm. Për më tepër, dhe duke marrë parasysh, pretendimet e parashtruesit të kërkesës në lidhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës, përkatësisht atë që ndërlidhet me rastin KI99/14 dhe KI100/14, bazuar në të cilin i njëjti pretendon që nuk i është drejtuar Gjykatës Themelore por Gjykatës Kushtetuese lidhur me

kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së, Gjykata i referohet Aktvendimit të saj për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22 dhe i cili përmban të gjitha sqarimet e nevojshme në këtë kontekst.

71. Gjykata rikujton që rastin e Gjykatës KI57/22 dhe 79/22, ajo ka refuzuar pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së, si rezultat i mos-shterimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj sipas kërkesave të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Në refuzimin e kësaj kërkesës si rezultat i kriterëve procedurale të ndërlidhura me detyrimin kushtetues për shterimin e mjeteve juridike, Gjykata, ndër tjerash, (i) ka shtjelluar parimet e përgjithshme përkitazi me detyrimin e shterimit të mjeteve juridike, përfshirë bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës; dhe (ii) ka aplikuar të njëjtat në rrethanat e rastit konkret (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22, cituar më lart, paragrafët 69-126). Në kontekst të kësaj të fundit, dhe siç është shtjelluar detajisht në Aktvendimin për Papranueshmërinë në rastin KI57/22 dhe 79/22, Gjykata, ndër tjerash, ka sqaruar që (i) bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, në parim, rregulli i shterimit të mjeteve juridike, duhet të zbatohet me një "*shkallë të fleksibilitetit dhe pa formalizëm të tepruar*"; por që gjithashtu (ii) bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, parashtruesit përkatës duhet të dëshmojnë se "*ata kanë bërë gjithëcka që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*" dhe që "*dyshimet e thjeshta*" të një parashtruesi rreth joefikasitetit të një mjeti juridik, nuk vlejné si arsye për ta liruar një parashtrues nga detyrimi kushtetues për shterimin e mjeteve juridike (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22, cituar më lart, paragrafët 73-76).
72. Për më tepër, Gjykata, përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin KI57/22 dhe 79/22, ndër tjerash, ka shtjelluar praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, në të gjitha rastet në të cilat është kërkuar vlerësimi i kushtetutshmërisë së akteve të autoriteteve publike përmes të cilave janë zgjedhur/emëruar dhe/ose refuzuar kandidatë të caktuar për pozita/funksione publike në Republikën e Kosovës dhe të cilat janë refuzuar si rezultat i mos-shterimit të mjeteve juridike, duke theksuar kështu në vazhdimësi, përmes praktikës së saj gjyqësore, që padia përmes konfliktit administrativ sipas përcaktimeve të LKA-së, është mjet efektiv juridik në rendin juridik të Republikës së Kosovës (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22, cituar më lart, paragrafët 79-90 dhe 104-124). Në të njëjtin Aktvendim për Papranueshmëri, ndër tjerash, në trajtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, gjithashtu janë sqaruar tri rastet e vetme relevante në kontekst të rrethanave të parashtruesit të kërkesës, me theks në rastin KI99/14 dhe KI100/14 dhe i cili ndërlidhet me procesin e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit në vitin 2014 (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22, cituar më lart, paragrafët 91-94). Në kontekst të këtij rasti, dhe duke rikujtuar që në rrethanat e tij e për dallim nga ky rast gjithashtu ishte ushtruar mjeti juridik i përcaktuar me ligjin respektiv për konfliktin administrativ në Gjykatën Themelore (shih, Aktgjykimin në rastet KI99/14 dhe KI100/14, cituar më lart, paragrafët 8 dhe 33), Gjykata ka sqaruar, ndër tjerash, që (i) nuk ka një të drejtë të fituar për lirimin nga detyrimi kushtetues për shterimin e mjeteve juridike; (ii) vlerësimi fleksibil dhe jo tejet i formalizuar i shterimit të mjeteve juridike bëhet nga rasti në rast, bazuar në barrën e të provuarit, sipas të cilës vet parashtruesi përkatës, duhet të tregojë që "*nuk ka mjet juridik në dispozicion*" dhe ka "*bërë gjithëcka që mund të pritët në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*" (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22, cituar më lart, paragrafët 104-124).
73. Në kontekstin e lartcekur, dhe duke shtjelluar argumentet bazuar në të cilat padia në konflikt administrativ është mjet efektiv juridik dhe është njohur si i tillë në mënyrë të



vazhdueshme nga Gjykata Kushtetuese, kjo e fundit, sqaroi që në rrethanat e rastit KI57/22, parashtruesi përkatës, nuk mund të lirohet nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike, sepse dhe ndër tjerash, parashtruesi i kërkesës para Gjykatës nuk ka argumentuar nëse (i) mjetet juridike ekzistuese nuk janë "*mjaftueshëm të sigurta jo vetëm në teori, por edhe në praktikë*" sepse të njëjtat, ndër tjerash, nuk janë në gjendje "*të ofrojnë zgjidhje përkitazi me pretendimet e një parashtruesi*" dhe "*të ofrojnë një mundësi të arsyeshme për sukses*"; dhe (ii) mjetet juridike përkatëse nuk janë në "*dispozicion, të qasshme dhe efektive*", argument ky që duhet të mbështetet në shembuj të praktikës gjyqësore të gjykatave të rregullta. Për më tepër, dhe duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata kishte theksuar që parashtruesi i kërkesës, bazuar në barrën e të provuarit, nuk ka argumentuar se "*ka bërë gjithçka që mund të pritet në mënyrë të arsyeshme nga ai që të shterojë mjetet juridike*", duke sqaruar gjithashtu që pretendimet që ndërliidhen me ngarkesën me lëndë në Departamentin për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, bazuar në praktikën e konsoliduar gjyqësore, kualifikohen si "*dyshimet e thjeshta*" dhe bazuar në to, Gjykata nuk mund të bëj lirimin nga përmbushja e një detyrimi kushtetues të një parashtruesi të kërkesës (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22, cituar më lart, paragrafët 104-124). Gjykata, përmes Aktvendimit të lartcekur, gjithashtu vuri theks në faktin që specifikat apo rëndësia e një funksioni, siç është rasti me emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit, si argument i vetëm, nuk mund të shërbejë si bazë për lirimin nga detyrimi për shterimin e mjeteve juridike sepse në të kundërtën, aplikimi i kriterit të përcaktuar në paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, do të mund të rezultonte në trajtim të pabarabartë të palëve të autorizuara për kontroll individual, për më tepër që, një qasje e tillë do të mund të rezultonte në konstatimin që sistemi juridik i Republikës së Kosovës dhe specifikisht funksionimi i gjykatave të rregullta, nuk është efektiv vetëm në kontekst të pozitave dhe/ose funksioneve të caktuara të shtetërore (shih, Aktvendimin për Papranueshmëri në rastet KI57/22 dhe 79/22, cituar më lart, paragrafin 121).

74. Me sqarimet e dhëna si më sipër, Gjykata në vijim do të trajtoj pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme dhe i cili sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, është nxjerrë në cenim të së drejtës së tij për qasje në drejtësi në kundërshtim me garancitë kushtetuese të përcaktuara në nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Për këtë qëllim dhe duke u bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, sipas të cilës, të drejtat dhe liritë themelore duhet të interpretohen në harmoni në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata në vijim (i) do të paraqes parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në kontekst të së drejtës për qasje në drejtësi; dhe më pas (ii) do të i aplikoj të njëjtat në rrethanat e rastit konkret.

#### **I. Parimet e përgjithshme të praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së përkitazi me të drejtën në qasje në drejtësi**

75. Përkitazi me të drejtën për "*qasje në drejtësi*", e drejtë kjo e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht vëren se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore të ndërtuar mbi parimet e vendosura nëpërmjet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Më saktësisht dhe në këtë kontekst, Gjykata rithekson që "*e drejta e qasjes në gjykatë*" për qëllimet e nenit 6 u përcaktua në rastin [Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 4451/70](#), Aktgjykimi 21 shkurtit 1975. Duke iu referuar parimeve të sundimit të ligjit dhe shmangies së kompetencës arbitrare që nënvizojnë KEDNJ-në, GJEDNJ konstatoi se e drejta e qasjes në gjykatë ishte një aspekt i qenësishëm i garancive të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastet e GJEDNJ [Markovic dhe të tjerët kundër Italisë](#), nr. 1398/03, Aktgjykim i 14 dhjetorit 2006, paragrafi 92; [Zubac](#)

*kundër Kroacisë*, nr. 40160/12, Aktgjykim i 5 prillit 2018, paragrafi 76). Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, kur nuk ka qasje në një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, do të ngritet çështja e respektimit të sundimit të ligjit. Kështu, në mënyrë që legjislacioni kombëtar të përjashtojë qasje në një gjykatë në përputhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së në një rast të veçantë, ai duhet të jetë në përputhje me parimin e sundimit të ligjit (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Grzęda kundër Polonisë*, nr. 43572/18, Aktgjykim i 15 marsit 2022, paragrafi 299, në kuadër të shqyrtimit të kushtit të dytë të testit Vilho Eskelinen). Po aq e rëndësishme, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta për një gjykim të drejtë, siç garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së, kërkon që palët ndërgjyqëse duhet të kenë një mjet juridik efektiv që u mundëson atyre të mbrojnë të drejtat e tyre civile (shih, rastin e GJEDNJ-së *Běleš dhe të Tjerët kundër Republikës Çeke*, nr. 47273/99, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 49).

76. Në kontekst të parimeve themelore që burojnë përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fillimisht duhet të theksohet që "*e drejta e qasjes në drejtësi*" përbën një element të rëndësishëm të ngërthyer në paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së. Ky i fundit, ndër tjerash, u siguron të gjithëve të drejtën për të iniciuar një procedurë për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile pranë një gjykate ose tribunali (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së *Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar*, cituar me lart, paragrafët 28-36). Për më tepër, kur ka një kontest serioz dhe të vërtetë në lidhje me ligjshmërinë e një ndërhyrjeje në të drejtat civile, neni 6 i KEDNJ-së, (i) i jep të drejtën individit në fjalë "*që kjo çështje e ligjit të brendshëm të përcaktohet nga një gjykatë*" (shih, rastet të GJEDNJ-së *Z dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 29392/95, Aktgjykim i 10 majit 2001, paragrafi 92; *Markovic dhe të Tjerët kundër Italisë*, cituar më lart, paragrafi 98); dhe (ii) refuzimi i një gjykate për të shqyrtuar pretendimet e individëve në lidhje me pajtueshmërinë e një procedure të caktuar me garancitë themelore procedurale të një gjykimi të drejtë kufizon qasjen e tyre në gjykatë (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Al-Dulimi dhe Montana Management Inc. kundër Zvicrës*, nr. 5809/08, Aktgjykim i 21 qershorit 2016, paragrafi 131).
77. Gjykata me tej thekson që bazuar në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, e drejta për "*qasje në drejtësi*" nuk është absolute, por mund t'i nënshtrohet kufizimeve, pasi që vet natyra e kësaj të drejte kërkon rregullim procedural nga shteti përkatës, i cili gëzon një liri të caktuar vlerësimi në këtë kontekst. Thënë këtë, bazuar në të njëjtën praktikë gjyqësore, përfshirë edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, çdo kufizim i të drejtës së "*qasjes në drejtësi*" nuk duhet të kufizojë ose zvogëlojë qasjen e një personi në atë mënyrë apo në një masë të tillë që të mund të dëmtohet vet thelbi i të drejtës së "*qasjes në drejtësi*" (shih, rastet e GJEDNJ-së *Stanev kundër Bullgarisë*, nr. 36760/06, Aktgjykim i 17 janarit 2012, paragrafi 229; *Baka kundër Hungarisë*, nr. 20261/12, Aktgjykim i 23 qershorit 2016, paragrafi 120; *Naït-Liman kundër Zvicrës*, nr. 51357/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 113; *Philis kundër Greqisë (nr. 1)*, nr. 12750/87; 13780/88; 14003/88, Aktgjykim i 27 gushtit 1991, paragrafi 59; dhe *De Geouffre de la Pradelle kundër Francës*, nr. 12964/87, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, paragrafi 28). Kufizime të tilla nuk do të jenë të pajtueshme me garancitë procedurale të KEDNJ-së, nëse ato (i) nuk ndjekin një qëllim legjitim ose (ii) nëse nuk ekziston një raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet (shih, rastet e GJEDNJ-së *Lupeni Greek Catholic Parish dhe të Tjerët kundër Rumanisë*, nr. 76943/11, 2016, paragrafi 89; dhe *Naït-Liman kundër Zvicrës*, nr. 51357/07, Aktgjykim i 15 marsit 2018, paragrafi 115).
78. Në parim, dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e drejta e qasjes në drejtësi duhet të jetë "*praktike dhe efektive*" (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Zubac kundër Kroacisë*, cituar më lart, paragrafët 76-79; *Bellet kundër Francës*, nr. 23805/94, 4

dhjetor 1995, paragrafi 38), duke pasur parasysh vendin e spikatur që ka në një shoqëri demokratike e drejta për një gjykim të drejtë (shih, rastin e GJEDNJ-së [Prince Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë](#), nr. 42527/98, Aktgjykim i 12 July 2001, paragrafi 45). Që e drejta e qasjes të jetë efektive, një individ duhet (i) “*të ketë një mundësi të qartë dhe praktike për të kontestuar një akt që ndërhyjnë në të drejtat e tij*” (shih, rastin e GJEDNJ-së [Bellet Bellet kundër Francës](#), nr. 23805/94, 4 dhjetor 1995, paragrafi 36); ose (ii) një mundësi e qartë dhe praktike për të kërkuar kompensim (shih, rastin e GJEDNJ-së [Georgel dhe Georgeta Stoicescu kundër Rumanisë](#), nr. 9718/03, Aktgjykim i 26 tetorit 2011, paragrafi 74).

79. Për aq sa është relevante në rrethanat e rastit konkret, të rëndësishme në kontekst të së drejtës së “*qasjes në drejtësi*”, janë edhe parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, bazuar në të cilën rregullat që rregullojnë hapat formalë që duhet të ndërmerren dhe afatet kohore që duhen respektuar për paraqitjen e një ankese ose një kërkesë për shqyrtim gjyqësor synojnë të sigurojnë administrimin e duhur të drejtësisë dhe respektimin, në veçanti, të parimit të sigurisë juridike (shih rastin e GJEDNJ-së [Cañete de Goñi kundër Spanjës](#), nr. 55782/00, Aktgjykim i 15 janarit 2003, paragrafi 36). Megjithatë çdo rast duhet të vlerësohet në dritën e karakteristikave të veçanta të procedurës në fjalë (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së [Kurşun kundër Turqisë](#), nr. 22677/10, Aktgjykim i 30 tetorit 2018, paragrafët 103-104) dhe në zbatimin e rregullave procedurale, gjykatat duhet të shmangin si formalizmin e tepruar që do të dëmtonte drejtësinë e procedurave, ashtu edhe fleksibilitetin e tepruar, e që do të bënte të pavlefshme kërkesat procedurale të përcaktuara në ligje të aplikueshme (shih, rastin e GJEDNJ-së [Hasan Tunç dhe të Tjerët kundër Turqisë](#), nr. 19074/05 Aktgjykim i 31 janarit 2017, paragrafët 32-33).
80. Për më tepër, dhe në kontekst të afateve kohore për iniciimin e padisë dhe veprimeve tjera procedurale, që është relevante në rrethanat konkret, praktika gjyqësore e GJEDNJ-së, ka trajtuar një numër rastesh, duke rezultuar, ndër tjerash, në parimet si një vijim (i) palët dhe përfaqësuesit e tyre duhet të veprojnë me vigjilencën dhe përkujdesjen e nevojshme (shih, rastin e GJEDNJ-së [Kamenova kundër Bullgarisë](#), nr. 62784/09, Aktgjykim i 12 korrikut 2018, paragrafët 52-55); (ii) gjykatat vendore nuk duhet të interpretojnë ligjin e aplikueshëm në një mënyrë jofleksibile/tejet formaliste me efektin e vendosjes së një detyrimi të cilin palët ndërgjyqëse nuk mund të përmbushnin, përkatësisht duke kërkuar që një ankesë të bëhet duke filluar nga momenti i vendimmarrjes në vend nga momenti në të cilën ankuesi/pala ka njohuri për vendimin përkatës – sepse në rrethana të tilla respektimi i afatit përkatës do të varej nga faktorë tërësisht jashtë kontrollit të ankuesit/palës përkatëse (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së [Ivanova dhe Ivashova kundër Rusisë](#), nr. 797/14 edhe 67755/14, Aktgjykim i 26 janarit 2017, paragrafi 57); dhe (iii) pranimiti i padive/ankesave jashtë afateve të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, për arsye që nuk duken të jenë veçanërisht bindëse, mund të rezultojë gjithashtu në shkelje të parimit të sigurisë juridike (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së [Magomedov dhe të Tjerët kundër Rusisë](#), nr. 33636/09 dhe të tjerët, Aktgjykim i 28 marsit 2017, paragrafët 87-89).
81. Për qëllime të vlerësimit të pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për cenimin e të drejtës përkatëse në “*qasjen në drejtësi*” të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, në vijim Gjykata do të prezentojë parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës në kontekst të së drejtës në “*qasje në drejtësi*”, specifikisht nga perspektiva e afateve ligjore për iniciimin e procedurave dhe afateve tjera procedurale. Për këtë qëllim, Gjykata do të përmbledh rastet specifike në të cilat çështje të tilla relevante për rrethana të rastit konkret janë trajtuar dhe kanë rezultuar në cenim ose jo të së drejtës në “*qasje në drejtësi*” në mënyrë që të njëjtat parime të aplikohen në rrethanat e rastit

konkret të parashtruesit të kërkesës. Gjykata, (i) fillimisht do të prezantojë rastet relevante të GJEDNJ-së, për të vazhduar me (ii) rastet relevante të Gjykatës.

(i) *Praktika relevante gjyqësore e GJEDNJ-së – qasja në drejtësi në kontekst të interpretimit të afateve procedurale të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm*

82. Në vijim, Gjykata do të pasqyrojë një sërë rastesh të GJEDNJ-së, të cilat kanë trajtuar në mënyrë specifike garancitë e “qasjes në drejtësi” të KEDNJ-së nga këndvështrimi i interpretimit të afateve procedurale të përcaktuara në ligjet përkatëse në fuqi. Rastet e paraqitura më poshtë, përkatësisht a) [Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke, nr. 46129/99](#), Aktgjykim i 12 nëntor 2002; b) [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës, nos. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98, 41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 and 41509/98](#), Aktgjykim i 25 janar 2000; c) [Ivanova dhe Ivashova kundër Ruisë, cituar më lart](#); dhe d) [Clavien kundër Zvicrës, nr. 16730/15](#), Vendim i 12 shtatorit 2017, përfshijnë rastet në të cilat GJEDNJ ka konstatuar ose jo shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në kuptimin e “qasjes në drejtësi” për shkak të interpretimit tepër formalist të afateve procedurale, duke i mundësuar Gjykatës të zbatojë më pas në rastin e parashtruesit të kërkesës, emëruesin e përbashkët të parimeve që burojnë nga praktika gjyqësore përkatëse e GJEDNJ-së.

a) *Zvolsky dhe Zvolská kundër Republikës Çeke*

83. Rrethanat e rastit në [Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, kanë të bëjnë me një kontratë për shitjen e një ferme dhe dhënien dhuratë të tokës fqinje, të lidhur në vitin 1967 ndërmjet parashtruesve dhe M.R. Në vitin 1991, M.R. gjithashtu nënshkroi një deklaratë në bazë të së cilës ai pohonte se e kishte bartur tokën përkatëse me vullnet të lirë. Megjithatë, në vitin 1993 ai inicioi procedura civile kundër parashtruesve, duke kërkuar anulimin e pjeshëm të marrëveshjes në lidhje me dhuratën e tokës fqinje. Gjykata respektive e qarkut vendosi në favor të M.R. Gjykata Rajonale e vërtetoi aktgjykimin përkatës duke shfuqizuar pjesën përkatëse të aktit të shitjes dhe të dhuratës. Gjykata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesve për të apeluar për çështje ligjore, duke konstatuar se aktgjykimi i Gjykatës Rajonale nuk ngrinte ndonjë çështje të rëndësisë juridike vendimtare. Vendimi përkatës ishte i datës 29 korrik 1997, por ai iu dorëzua parashtruesve më 11 shtator 1997 dhe ankimi i tyre në Gjykatën Kushtetuese u dorëzua më 12 nëntor 1997. Më 4 gusht 1998, Gjykata Kushtetuese e shpalli ankimin e tyre të papranueshëm si të pasafatshëm, ndër të tjera, duke arsyetuar se (i) palët ndërgjyqëse nuk kanë të drejtë të iniciojnë procedura në Gjykatën Supreme që nuk kualifikohen për t’u lejuar sipas rregullave të ligjit ose të bëjnë kërkesë në një procedurë për nxjerrjen e urdhrit që prish vendimet e gjykatave të rregullta; (ii) ankimi kushtetues mund të ngrihej vetëm kundër vendimit të gjykatës së apelit, i cili u bë i formës së prerë më 15 maj 1996; dhe (iii) marrë parasysh që ankesa në Gjykatë Kushtetuese, mund të bëhej vetëm pas vendimit përkatës të gjykatës së apelit në kontekst të këtij rasti, afati ligjor për të apeluar vendimin e Gjykatës Rajonale para Gjykatës Kushtetuese kishte kaluar (shih, [Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafët 9-17).

84. Para GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës pohuan se ka shkelje në aspektin e të drejtës për qasje në drejtësi dhe barazisë para ligjit, kryesisht për shkak të faktit se (i) praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese ishte divergjente në lidhje me çështjen e mjeteve juridike në dispozicion, përkatësisht nëse ankesa përkatëse duhej të ishte dorëzuar në Gjykatën Supreme ose në Gjykatën Kushtetuese pas vendimit të Gjykatës së Apelit si dhe afatet për paraqitjen e ankesës në Gjykatën Kushtetuese; dhe (ii) më 1 janar 1996, përkatësisht përpara vendimit të Gjykatës së Apelit në rastin e tyre, kodi civil përkatës u ndryshua, duke i dhënë Gjykatës Supreme kompetencën për të vlerësuar çështjet ligjore kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, duke sqaruar kështu

se ankesa në Gjykatën Supreme ishte një mjet juridik efektiv (shih, [Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafët 41-44). Nga ana tjetër, Qeveria pohoi se nuk ka shkelje për sa i përket qasjes në drejtësi, kryesisht për shkak të faktit se (i) ankesa në Gjykatën Supreme do të kishte qenë efektive vetëm nëse argumentohej për çështjet ligjore; (ii) parashtruesit e kërkesës duhet të kishin parashtruar ankesën e tyre kushtetuese në të njëjtën kohë me ankesën në Gjykatën Supreme, në mënyrë që të shmangnin rrezikun e të qenit jashtë afatit gjashtëdhjetë (60) ditësh nëse do t'u refuzohej leja për t'u ankuar për çështje ligjore; dhe (iii) meqenëse parashtruesit e kërkesës nuk kishin marrë masat paraprake për të paraqitur dy ankesat njëkohësisht për të shmangur të qenit jashtë afatit kohor për paraqitjen e një ankese kushtetuese, ata, për shkak të neglizhencës së tyre, e kishin privuar veten nga një mjet i brendshëm i qasshëm dhe efektiv (shih, [Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafët 39-40).

85. Në vlerësimin e parimeve që kanë të bëjnë me të drejtën për qasje në drejtësi, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, pohoi se (i) një nga aspektet themelore të sundimit të ligjit, kërkon që të gjitha palët ndërgjyqëse duhet të kenë një mjet juridik efektiv që u mundëson atyre të theksojnë të drejtat civile; por gjithashtu që (ii) “e drejta për gjykatë”, një aspekt i së cilës është e drejta e qasjes në drejtësi, nuk është absolute pasi i nënshtrohet kufizimeve, veçanërisht kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankese, pasi nga vetë natyra e saj kërkon rregullim nga shteti dhe se rregullat për procedurën dhe afatet kohore për ankesa janë krijuar për të garantuar administrimin e duhur të drejtësisë dhe, në veçanti, sigurinë juridike. Megjithatë, GJEDNJ gjithashtu kishte theksuar që kufizimet do të jenë në përputhje me nenin 6 të KEDNJ-së vetëm nëse ato ndjekin një qëllim legjitim dhe ekziston një marrëdhënie e arsyeshme proporcionaliteti ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit legjitim të ndjekur (shih, [Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafët 46-47).
86. GJEDNJ-ja konstatoi shkelje në këtë rast, ndër të tjera, duke iu referuar legjisllacionit në fuqi, përkatësisht Ligjit përkatës të Gjykatës Kushtetuese, në bazë të të cilit ankesat kushtetuese duhet të bëhen brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e dorëzimit të ankuesi të vendimit përfundimtar të mjetit juridik për mbrojtjen e të drejtave të tij/saj. Sipas arsytimit përkatës, ligji nuk sqaronte nëse mjete juridik i formës së prerë kishte të bënte me mjetet juridike të rregullta apo të jashtëzakonshme, dhe për rrjedhojë, veçanërisht për shkak të ndryshimeve në kodin civil përkatës ndërkohë, afati gjashtëdhjetë (60) ditësh duhej të ishte llogaritur duke filluar nga vendimi përfundimtar i Gjykatës Supreme dhe jo vendimit përfundimtar të Gjykatës së Apelit, siç konstatoi Gjykata Kushtetuese përkatëse kur e shpalli kërkesën e parashtruesve të papranueshme si të pasafatshme (shih, [Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke](#), cituar më lart, paragrafët 48-53).

b) *Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës*

87. Rrethanat e rastit [Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës](#), kanë të bëjnë me disa beneficione për kimistët në Spanjë, të cilat u caktuan me një urdhër ministror më 22 janar 1982 dhe të cilat më pas u reduktuan me një urdhër ministror më 10 gusht 1985, kundër të cilit Shoqata Kombëtare e Kimistëve të Spanjës filloi procedurën gjyqësore. Gjykata Supreme përkatëse anuloi urdhrin ministror. Aktgjykimi i Gjykatës Supreme u nxor më 4 korrik 1987 dhe ai iu dorëzua Shoqatës Kombëtare të Kimistëve më 7 korrik 1987, por jo parashtruesve të kërkesës, pasi ata nuk ishin palë në procedurë. Me rëndësi për rrethanat e rastit, aktgjykimi i Gjykatës Supreme u bë publik më 5 nëntor 1987, me publikimin në Gazetën Zyrtare. Në procedura të veçanta, më 5 dhe 6 korrik 1988, parashtruesit paraqitën kërkesa pranë Departamentit të Përgjithshëm Administrativ Shtetëror për pagesën e kompensimit për dëmin e shkaktuar si rezultat i urdhrin ministror. Kërkesat e tyre u hodhën poshtë si të

pasafatshme, sepse autoritetet përkatëse llogaritën se afati njëvjeçar i përcaktuar me ligj kishte filluar nga momenti i marrjes së vendimit të Gjykatës Supreme, përkatësisht 4 korriku 1987 dhe jo 7 korriku apo 5 nëntori 1987. përkatësisht kur vendimi përkatës i Gjykatës Supreme i është dorëzuar Shoqatës Kombëtare të Kimistëve ose është bërë publik përmes publikimit në Gazetën Zyrtare. Gjykata Supreme dhe Gjykata Kushtetuese vërtetuan interpretimin e autoriteteve administrative, duke konstatuar se kërkesat përkatëse për kompensim u paraqitën dy ditë jashtë afatit ligjor të përcaktuar me ligj (shih, [Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafët 11-20).

88. Para GJEDNJ-së, parashtruesit e kërkesës pretenduan se ka shkelje për sa i përket qasjes në drejtësi, duke argumentuar interpretimin tepër kufizues të afateve ligjore nga gjykatat përkatëse, duke marrë parasysh se nuk mund të pritej që parashtruesit e kërkesës të kishin dijeni për datën në të cilën është nxjerrë aktgjykimi i Gjykatës Supreme, por afatet ligjore duhet të llogariten nga data në të cilën aktgjykimi përkatës u bë publik, përkatësisht nga data 5 nëntor 1987 (shih, [Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafët 26 dhe 28-29). Nga ana tjetër, Qeveria pretendoi se nuk ka shkelje për sa i përket qasjes në drejtësi, kryesisht për faktin se (i) Aktgjykimi përkatës i Gjykatës Supreme që shfuqizoi urdhrin ministror ishte i datës 4 korrik 1987 dhe se nga kjo datë ka filluar të ecë afati ligjor njëvjeçar; dhe (ii) se 16,000 nëpunës civilë kanë parashtruar kërkesa për kompensim brenda këtij afati, ndryshe nga parashtruesit e kërkesës (shih, [Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafi 30).
89. GJEDNJ-ja konstatoi shkelje në këtë rast, ndër të tjera, duke pohuar se (i) parashtruesit e kërkesës nuk ishin palë në procedurën fillestare dhe për këtë arsye aktgjykimi fillestar i Gjykatës Supreme, përkatësisht ai i 4 korrikut 1987 nuk iu dorëzua atyre; dhe (ii) palët duhet të jenë në gjendje të përfitojnë nga e drejta për të ngritur një padi ose për të parashtruar një ankesë që nga momenti kur ato mund të ishin njoftuar në mënyrë efektive për vendimet gjyqësore që u ngarkojnë atyre një barrë ose që mund të cenojnë të drejtat ose interesat e tyre legjitime. Në thelb, bazuar në vlerësimin e GJEDNJ-së, interpretimi i autoriteteve vendore, në bazë të të cilit afati duhet të ishte llogaritur nga momenti i nxjerrjes së vendimit të kontestuar në vend se nga momenti i bërjes publike të vendimit të kontestuar, vendosi një barrë joproportionale mbi parashtruesit e kërkesës dhe rezultoi në shkeljen e lartpërmendur të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, [Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës](#), cituar më lart, paragrafët 36-39).

c) *Ivanova dhe Ivashova kundër Rusisë*

90. Rrethanat e rastit [Ivanova dhe Ivashova kundër Rusisë](#), kanë të bëjnë me dy parashtruese të cilat kanë iniciuar procedura të veçanta, por pretendimet e të cilave janë refuzuar nga gjykatat përkatëse për aspekte procedurale që kanë të bëjnë me përlllogaritjen e afateve. Parashtruesja e parë, përkatësisht Ivanova, kishte iniciuar procedura ligjore në lidhje me përfitimet e sigurimeve shoqërore. Gjykata përkatëse e rrethit ftoi parashtruesen të korrigjonte parregullsitë e ankesës së saj, me paralajmërimin e papranueshmërisë së kërkesës përkatëse në të kundërtën. Më 28 maj 2013, rasti u refuzua si i papranueshëm. Parashtruesja e ankmoi vendimin përkatës në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se nuk kishte pranuar asnjëherë kërkesën e gjykatës më të ulët për të plotësuar ankesën e saj. Gjykata Supreme vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut (shih, [Ivanova dhe Ivashova kundër Rusisë](#), cituar më lart, paragrafët 6-12). Nga ana tjetër, parashtruesja e dytë, përkatësisht Ivashova, kishte iniciuar padi civile kundër një kompanie private. Më 18 shkurt 2014, Gjykata përkatëse e Qarkut e pranoi pjesërisht kërkesën e saj. Dispozitivi i vendimit përkatës u lexua publikisht në seancë, por parashtruesja, me gjithë kërkesat e përsëritura, nuk

mori një kopje të vendimit deri më 25 mars 2014. Megjithatë dhe përkundër faktit se nuk e kishte marrë ende kopjen e vendimit, ajo parashtrroi ankesën përkatëse në një gjykatë më të lartë më 18 mars 2014, duke shpjeguar se argumentet e saj ligjore do të plotësoheshin më tej pasi të merrej vendimi i kontestuar. Gjykata përkatëse i dha parashtrueses së kërkesës afat për plotësimin e ankesës, përkatësisht deri më 12 prill 2014, por ky vendim arriti te parashtruesja vetëm më 9 prill 2014. Më 23 prill 2014, gjykata përkatëse refuzoi ankesën e parashtrueses dhe vendimin që u vërtetua nga gjykata e qytetit të Shën Petersburgut (shih, [Ivanova dhe Ivashova kundër Ruisë](#), cituar më lart, paragrafët 13-23).

91. Në vlerësimin e parimeve që kanë të bëjnë me të drejtën për qasje në drejtësi, GJEDNJ-ja, ndër të tjera, konstatoi se (i) e drejta për gjykatë nënkupton gjithashtu të drejtën për të marrë njoftim adekuat për vendimet gjyqësore, veçanërisht në rastet kur duhet të bëhet ankesë brenda një afati të caktuar kohor; dhe (ii) e drejta e padisë ose ankesës duhet të ushtrohet që nga momenti kur palët e interesuara mund të dinë realisht për vendimet gjyqësore që u ngarkojnë atyre një barrë ose mund të cenojnë të drejtat ose interesat e tyre legjitime (shih, [Ivanova dhe Ivashova kundër Ruisë](#), cituar më lart, paragrafët 43 dhe 45). Në këtë aspekt, GJEDNJ nuk gjeti shkelje në rastin e Ivanovës, por konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNJ-së në rastin e Ivashovës. Për sa i përket të parës, GJEDNJ, ndër të tjera, pohoi se parashtruesja e kërkesës ishte në dijeni të njoftimit të Gjykatës që kërkonte plotësimin e ankesës fillestare ose ajo duhet të ketë qenë në dijeni dhe duhet të kishte vepruar në mënyrë proaktive, duke shtuar gjithashtu se palët në procedurë duhet të bëjnë maksimumin për të mbrojtur interesat e tyre dhe se, në rastin konkret, parashtruesja nuk tregoi një kujdes të tillë duke lejuar që të kalonte afati i caktuar nga gjyqtari për të korrigjuar parregullsitë në kërkesën e saj (shih, [Ivanova dhe Ivashova kundër Ruisë](#), cituar më lart, paragrafët 49-50). Në lidhje me të dytën, GJEDNJ pohoi se duke refuzuar ankesën e parashtrueses për vonesë/pasafatshmëri, gjykatat vendore bënë një interpretim tejet formalist të ligjit të aplikueshëm që kishte si pasojë vendosjen e një detyrimi mbi parashtruesen, të cilin ajo nuk ishte në gjendje ta përmbushte, madje edhe duke treguar kujdes të veçantë. Kjo kryesisht për shkak se gjykatat vendore i kishin llogaritur afatet e ankesës që nga momenti i marrjes së vendimit të kontestuar dhe jo nga momenti nga i cili parashtruesja e kërkesës kishte qasje në të, pavarësisht përpjekjeve të saj të vazhdueshme në këtë drejtim, duke përfshirë paraqitjen e ankesës përkatëse brenda afatit përkatës, Ende pa marrë tekstin e plotë të vendimit të kontestuar sepse i njëjti ende nuk i ishte vënë në dispozicion (shih, [Ivanova dhe Ivashova kundër Ruisë](#), cituar më lart, paragrafi 57).

d) *Clavien kundër Zvicrës*

92. Në fund, rrethanat e rastit [Clavien kundër Zvicrës](#), cituar më lart, lidhen me procedurat ligjore të iniciuara në lidhje me një proces të falimentimit. Vendimi i parë për këtë çështje u nxor më 15 maj 2014, i cili iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 2 qershor 2014. Parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Kantonale, e cila ankesë u refuzua më 21 gusht 2014, dhe për të cilin parashtruesi i kërkesës u njoftua më 26 gusht 2014. Në Vendimin e Gjykatës Kantonale theksohej se parashtruesi i ka tridhjetë (30) ditë kohë për të paraqitur ankesën përkatëse, megjithatë, ligji në fuqi, përkatësisht Ligji për Gjykatën Federale, përcaktonte se ankesa duhej dorëzuar brenda dhjetë (10) ditësh. Ky vendim u apelua në Gjykatën Federale më 25 shtator 2014. Gjykata Federale, me një vendim të datës 2 tetor 2014, të njoftuar/publikuar më 7 tetor 2014, e shpalli ankesën e parashtruesit të papranueshme me arsyetimin se ishte e pasafatshme, duke vënë në dukje se afati dhjetë (10) ditor për ankesë kishte skaduar më 5 shtator 2014. Aktgjykimi përkatës i Gjykatës Federale, ndër të tjera, theksoi se (i) kërkesat ndaj avokatëve ishin më të larta dhe se nga këta të fundit pritej që në të gjitha rastet të bënin një shqyrtim të kujdesshëm të mjeteve juridike dhe afateve në

dispozicion; dhe (ii) avokati i parashtruesit, i cili e kishte përfaqësuar atë si përpara autoritetit kantonal ashtu edhe përpara Gjykatës Federale, mund ta kishte kuptuar pasaktësinë në lidhje me këshillën përkatëse juridike mbi mjetet juridike thjeshtë duke lexuar legjislacionin në fuqi (shih, [Clavien kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafët 3-7).

93. Duhet theksuar se ligji përkatës për Gjykatën Federale, përfshinte tri dispozita përkatëse, në bazë të të cilave parashtruesi i kërkesës pretendonte se ishte shkelur e drejta e tij për qasje në drejtësi e garantuar me nenin 6 të KEDNJ-së, për faktin se afati që ai ndoqi për të parashtruar ankesën e tij në Gjykatën Federale bazohej në këshillën juridike të Gjykatës Kantonale, përkatësisht (i) nenin 49 (Njoftimi i parregullt) në bazë të të cilit, njoftimi i parregullt, veçanërisht për shkak të treguesit të pasaktë ose jo të plotë të mjeteve juridike ose mungesës së këtij treguesi nëse është parashkruar, nuk duhet t'u shkaktojë asnjë dëm palëve; (ii) neni 50 (Rikthimi), në bazë të të cilit, ndër të tjera, nëse për ndonjë arsye përveç njoftimit të parregullt, pala ose përfaqësuesi i saj është penguar të veprojë brenda afatit të caktuar pa faj të tij, afati kohor do të rikthehet me kusht që pala ta kërkojë këtë, duke treguar arsyen, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita në të cilën është hequr pengesa; dhe (iii) neni 100 (Ankesa kundër një vendimi), në bazë të të cilit ankesa kundër një vendimi duhet të parashtrohet në Gjykatën Federale brenda tridhjetë (30) ditëve pas njoftimit të dërgesës së plotë dhe se afati kohor për ankesë është dhjetë (10) ditë kundër vendimeve të një autoriteti mbikëqyrës kantonal në lidhje me ekzekutimin e borxhit dhe falimentimin (shih, [Clavien kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafi 10).
94. Në shqyrtimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljen e nenit 6 të KEDNJ-së për shkak të mohimit të qasjes në drejtësi për shkak të vendimit të Gjykatës Federale se ankesa e tij ishte jashtë afatit, GJEDNJ-ja aplikoi testin përkatës në këtë drejtim dhe arriti në përfundimin se ndonëse nuk kishte dyshim se masa e kontestuar, përkatësisht respektimi i afateve të përcaktuara në ligj, ndiqte qëllime legjitime, përkatësisht, administrimin e duhur të drejtësisë dhe respektimin e parimit të sigurisë juridike, masa ishte gjithashtu proporcionale me qëllimet e ndjekura, duke arritur kështu në përfundimin se e drejta e parashtruesit për qasje në drejtësi, siç garantohet me nenin 6 të KEDNJ-së, nuk ishte shkelur, duke hedhur poshtë pretendimet e parashtruesit të kërkesës si qartazi të pabazuara (shih, [Clavien kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafët 27 dhe 30).
95. Në lidhje me këtë të fundit, GJEDNJ, ndër të tjera, konstatoi se (i) është pikërisht në kontekstin e së drejtës së qasjes në drejtësi që ajo ka zhvilluar në mënyrë më të veçantë parimin sipas të cilit është e përshtatshme të interpretohen dhe zbatohen dispozitat e KEDNJ-së, në një mënyrë që i bën kërkesat e saj “konkrete dhe efektive”; dhe (ii) është gjithashtu e nevojshme të merren parasysh veçoritë e secilit rast konkret në mënyrë që të shmanget zbatimi mekanik i dispozitave ligjore në një situatë të caktuar (shih, [Clavien kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafi 22).
96. GJEDNJ në shqyrtimin e rrethanave të rastit, mori parasysh (i) nenet 49, 50 dhe 100 të Ligjit për Gjykatën Federale; (ii) faktin që parashtruesi i kërkesës përfaqësohej nga një avokat; dhe (iii) faktin që afati për fillimin e procedurës përkatëse ishte përcaktuar qartë në ligj, pavarësisht nga fakti se parashtruesi ishte këshilluar gabimisht nga Gjykata përkatëse Kantonale për sa i përket afateve kohore brenda të cilave duhet të ishte dorëzuar ankesa përkatëse, dhe arriti në përfundimin se (i) gabimet e bëra nga përfaqësuesit e parashtruesit në parim nuk përfshijnë përgjegjësinë e autoriteteve sipas KEDNJ-së; dhe (ii) në rrethanat e rastit konkret, Gjykata Federale përkatëse mori parasysh mjaftueshëm rrethanat e veçanta të rastit konkret dhe nuk e interpretoi ligjin e aplikueshëm në mënyrë tejet formaliste (shih, [Clavien kundër Zvicrës](#), cituar më lart, paragrafët 16-18 dhe 23-27).



(ii) *Praktika relevante gjyqësore e Gjykatës – qasja në drejtësi në kontekst të interpretimit të afateve procedurale të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm*

97. Gjykata, në dy raste, ka trajtuar interpretimin e afateve procedurale të përcaktuara në ligjin e aplikueshme nga gjykatat e rregullta, duke konstatuar cenimin e të drejtës në qasje në drejtësi të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkatësisht në (i) rastin [KI54/21](#), me parashtrues, [Kamber Hoxha](#), Aktgjykim i 2 dhjetorit 2021 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI54/21); dhe (ii) rastin [KI55/21](#), me parashtrues, [Muhamet Ademi](#), Aktgjykim i 6 qershorit 2022 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i Gjykatës në rastin KI55/21).
98. Rrethanat e të dy rasteve, ndërliidhen me oficerë korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe të cilëve, si rezultat i konstatimit të shkeljes së kodit respektiv të etikës, përkatësisht shkeljeve disiplinore, u ishin ndërprerë marrëdhëniet e punës në qershor të vitit 2004. Rrethanat faktike dhe juridike të dy rasteve janë të ngjashme. Të njëjtat reflektojnë procedura të ndjekura në gjykatat e rregullta dhe të cilat kishin trajtuar pretendimet përkatëse të parashtruesve të kërkesës në merita për më shumë se një dekadë dhe të cilat përfundimisht përmes vendimeve përkatëse të Gjykatës Supreme të vitit 2021, ishin refuzuar me arsyetimin që paditë fillestare, përkatësisht ato të vitit 2004, ishin të pasafatshme.
99. Më saktësisht, parashtruesi i kërkesës në rastin KI54/21, bazuar në rregullativën e aplikueshme, përkatësisht Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36, kundër vendimit për ndërprerjen përkatëse të punës dhe të cilit i mungonte këshilla juridike, më 13 korrik 2004, kishte paraqitur ankesë në shkallën e dytë të punëdhënësit, i cili, më 26 janar 2005, kishte refuzuar ankesën përkatëse dhe për pasojë më 2 shkurt 2005, parashtruesi përkatës kishte paraqitur padinë përkatëse në Gjykatë Komunale. Që nga viti 2005, gjykatat e rregullta kishin trajtuar rastin e tij në merita, duke filluar me (i) Gjykatën Komunale e cila vendosi në favor të parashtruesit të kërkesës, duke miratuar kërkesëpadinë e tij dhe duke e detyruar punëdhënësit që parashtruesin e kërkesës të kthejë në vendin e tij të punës; (ii) Gjykatën e Qarkut, e cila kishte kthyer çështjen në rivendosje, duke vënë theksin, ndër tjerash, në kompetencën e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për të trajtuar rastin; (iii) vendimmarrjen e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, i cili kishte refuzuar kompetencën përkatëse me arsyetimin që në kohën e shkeljes përkatëse disiplinore e njëjta nuk ka qenë e themeluar; (iv) Gjykatën Komunale, e cila përmes Aktgjykimit të vitit 2010, sërish kishte vendosur në favor të parashtruesit përkatës; (v) Gjykatën e Apelit, e cila gjithashtu kishte vendosur në favor të parashtruesit përkatës; (vi) Gjykatën Supreme, e cila, kishte kthyer çështjen në rivendosje vetëm përkitazi me njërën pikë të dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, por e cila nuk e kishte kontestuar afatshmërinë e padisë fillestare të vitit 2004; dhe (vii) Gjykatën Themelore e cila në vitin 2016, sërish vendosi në favor të parashtruesit të kërkesës.
100. Në vitin 2020, duke e trajtuar ankesën e punëdhënësit, Gjykata e Apelit, e kishte refuzuar kërkesë padinë e parashtruesit të kërkesës, duke u referuar në nenin 83 të Ligjit për të Drejtat Themelore nga Marrëdhënia e Punës të vitit 1989, duke konstatuar që padia fillestare e paraqitur në vitin 2004 ishte e paraqitur jashtë afateve procedurale të përcaktuara në ligjin e lartcekur. Aktvendimin përkatës të Gjykatës së Apelit e kishte miratuar edhe Gjykata Supreme (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI54/21, cituar më lart, lidhur faktet dhe rrethanat e rastit, paragrafët 17-41). Në vlerësimin e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, duke vënë theks, (i) në parimet që burojnë nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së në kontekst të së drejtës në qasje në drejtësi, dhe gjithashtu (ii) faktin që vet Gjykata e Apelit kishte trajtuar rastin e parashtruesit të kërkesës dy herë, përkatësisht në vitet 2006 dhe 2014 dhe Gjykata

Supreme në vitin 2015, duke mos e kontestuar asnjëherë afatshmërinë e padisë fillestare të parashtruesit të kërkesës, ndërsa në vitin 2020 dhe 2021, respektivisht, e kishin cilësuar padinë fillestare si të pasafatshme, Gjykata konstatoi, që në rrethanat specifike të këtij rasti, qëllimi legjitim i administrimit të duhur të drejtësisë që përfshinë edhe respektimin e afateve procedurale të përcaktuara në ligj, nuk vazhdonte të ishte më tej proporcional me qëllimin e ndjekur, dhe si rezultat i formalizmit të tepruar nuk ishte më tej në shërbim të sigurisë juridike dhe kishte cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në drejtësi (shih, Aktgjykimin e Gjykatës në rastin KI54/21, cituar më lart, lidhur vlerësimin e Gjykatës, paragrafët 52-94). Në rrethana të ngjashme faktike dhe juridike, Gjykata, njëjtë ka konstatuar edhe në rrethanat e rastit KI55/21.

## II. Aplikimi i parimeve të shtjelluara më sipër në rrethanat e rastit konkret

101. Në kontekst të aplikimit të parimeve të lartcekura në rrethanat e rastit konkret, Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës konteston aktet e kontestuara të KPK-së të 6 prillit 2022. Të njëjtat, më 28 prill 2022, i kishte kontestuar para Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre, kërkesë kjo të cilën Gjykata e kishte refuzuar për faktin që parashtruesi i kërkesës nuk kishte shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj sipas kërkesave të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës. Aktvendimi për Papranueshmëri i Gjykatës në rastin KI57/22 dhe 79/22, ishte nxjerrë dhe komunikuar më 4 korrik 2022 dhe ishte publikuar më 26 korrik 2022.
102. Më 28 korrik 2022, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Gjykatës Themelore duke kontestuar aktet e KPK-së të 6 prill 2022, dhe duke kërkuar gjithashtu caktimin e sigurimit të kërkesëpadisë me masën e përkohshme, përkatësisht shtyrjen e ekzekutimit të akteve të kontestuara. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte kontestuar faktin që padia përkatëse ishte paraqitur jashtë afatit prej tridhjetë (30) ditësh sipas përcaktimeve të nenit 27 të LKA-së. Por parashtruesi i kërkesës, pretendonte që padia e tij duhet të konsiderohej e afatshme bazuar në nenin 28 të LKA-së dhe 129 dhe 130 të LPK-së, respektivisht.
103. Më saktësisht, bazuar në (i) paragrafin 2 të nenit 28 të LKA-së, nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës, por "*organit tjetër jo-kompetent*", ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e "*mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit*"; (ii) paragrafin 1 të nenit 129 të LPK-së, në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural dhe për këtë shkak e humbë të drejtën që më vonë të kryejë veprimin procedural të lidhur me afat, gjykata do t'i lejojë kësaj pale, me propozimin e saj, ta kryejë më vonë këtë veprim, po që se e konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen, ndërsa bazuar në paragrafin 2 të nenit 129 të LPK-së, kur lejohet kthimi në gjendje të mëparshme procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit dhe prishen të gjitha vendimet që i ka dhënë gjykata për shkak të mosveprimit; dhe (iii) bazuar në nenin 130 të LPK-së, propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme i paraqitet gjykatës në të cilën është dashur të kryhet veprimi procedural i pakryer; propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditor nga dita kur ka pushuar shkakun i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin, ndërsa pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme.
104. Bazuar në dispozitat e lartcekura, para gjykatave të rregullta, parashtruesi i kërkesës, theksonte (i) që bazuar në nenin 28 të LKA-së, padia e tij duhet të konsiderohet e afatshme, sepse, sipas pretendimit, si rezultat i "*mos dijës apo e gabimit të hapur*",

padia, përkatësisht kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të KPK-së, ishte dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese, përkatësisht në *“organin jo-kompetent”*, dhe për pasojë, padia e tij në Gjykatën Themelore, duhet të jetë konsideruar të ketë arritur me kohë, duke marrë parasysh që kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese ishte dorëzuar brenda afatit tridhjetë (30) ditor të përcaktuar në LKA; dhe (ii) që bazuar në nenin 129 të LPK-së, duke marrë parasysh që ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen, gjykatat e rregullta duhet të lejojnë parashtruesin për të kryer veprimin procedural, përkatësisht inicimin e konfliktit administrativ, pas afateve të përcaktuara në ligj.

105. Gjykatat e rregullta, përkatësisht Gjykata Themelore, e Apelit dhe Supreme, respektivisht, refuzuan padinë e parashtruesit të kërkesës si të pasafatshme duke u referuar në nenin 27 të LKA-së, ndërsa refuzuan pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aplikueshmërinë e neneve 28 të LKA-së dhe 129 dhe 130 të LPK-së, respektivisht.
106. Në kontekst të afatshmërisë së padisë, përkatësisht kërkesës së përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 27 të LKA-së, gjykatat e rregullta, theksuan që padia paraqitet brenda tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës, ndërsa në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, padia ishte paraqitur më 28 korrik 2022 lidhur me aktet e 6 prillit 2022 dhe për pasojë, ishte paraqitur jashtë afateve të përcaktuara me ligjin e aplikueshëm, përkatësisht LKA-në.
107. Në kontekst të pretendimit që padia duhej të konsiderohej e afatshme bazuar në nenin 28 të LKA-së, sepse si pasojë e *“mos dijës apo gabimit të hapur”*, i ishte dorëzuar *“organit jo-kompetent”*, përkatësisht, sipas pretendimit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Themelore, në parim, sqaroi që (i) dallon objekti i çështjes, duke theksuar, ndër tjerash, që *“nga shkresat tjera të kësaj lënde administrative, përkatësisht nga Aktvendimi për pa pranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese Nr. ref. RK 2027/22 dt. 25 korrik 2022, gjykata gjeti se objekt i çështjes në Kushtetuese ka qenë Vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të KPK-së nga 06 prill 2022, kurse këtu paditësi përmes Propozimit dhe Padisë së dorëzuar më dt. 28.07.2022 në Departamentin Administrativ të kësaj Gjykate, kërkon që fillimisht të shtyhet ekzekutimi dhe në fund të procedurës gjykata me vendim të prerë ti anulohet vendimet e cekura të të paditurës, të anulohet në tërësi procesi i intervistimit si kundërkushtetues dhe i kundërligjshëm dhe ti rikthehet KPK-së që nga fillimi procesi i emërimit të Kryeprokurorit”*; dhe (ii) neni 28 i LKA-së, është i aplikueshëm atëherë kur padia është dorëzuar si pasojë e *“mos dijës apo gabimit të hapur”* në *“organin jo-kompetent”*, dhe ky i fundit, do të i dorëzonte padinë gjykatës kompetente, duke theksuar, ndër tjerash, që në rast se *“Institucioni Kushtetues të cilit paditësi i kishte drejtuar kërkesën e cekur më lartë, të njëjtën do ja dërgonte në kompetencë për procedim kësaj gjykate, do të konsiderohej si kërkesë e afatshme, po që se pala i është drejtuar institucionit brenda afatit të përcaktuar me nenin 27 paragrafit 1 të LKA, edhe po që se në këtë gjykatë kishte me arrij të pas afatit ligjor për Inicim të Konfliktit Administrativ”*.
108. Të njëjtin qëndrim të Gjykatës Themelore, në kontekst të aplikueshmërisë së nenit 28 të LKA-së, e konfirmoi edhe Gjykata e Apelit, e cila gjithashtu kontestoi pretendimin e parashtruesit të kërkesës përkitazi me *“mos dijën apo gabimin e hapur”*, si njërin nga kushtet për aplikueshmërinë e nenin 28 të LKA-së, duke theksuar, ndër tjerash, që *“paditësi nuk mund të thirret në gabimin e hapur të tij në drejtimin e padisë në organin jo kompetent, duke u bazuar në tri raste kur Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e ka marrë kompetencën e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative, për të vlerësuar aktet përfundimtare të nxjerra nga ana e organeve administrative, kjo për faktin se paditësi dhe autorizuari*

*i tij kanë arsimim të duhur ligjor, dhe se kanë qenë dashur të dinë se rendi juridik në Republikën e Kosovës, është ndërtuar mbi bazën e ligjeve e jo të precedentit gjyqësor, dhe se sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka kompetencë ekskluzive për të vlerësuar ligjshmërinë e akteve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative nga ana e organeve administrative, e jo të ndiqet precedenti gjyqësor, i krijuar nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës me tri raste, dhe në këtë kuptim ky pretendim i paditësit është i pa qëndrueshëm, e rrjedhimisht edhe i pa bazuar”.*

109. Përfundimisht, edhe Gjykata Supreme, në kontekst të aplikueshmërisë së nenit 28 të LKA-së, konfirmon vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, duke vënë theks në faktin që për aplikueshmërinë e nenit të lartcekur, duhet të plotësohen dy kushte, përkatësisht (i) që padia të i jetë dorëzuar “organit jo-kompetent” si pasojë e “mos dijës apo gabimit të hapur”; dhe (ii) që e njëjta të arrijë në organin kompetent pas afatit të përcaktuar me ligj. Në kontekst të këtyre dy kritereve, Gjykata Supreme, thekson që (i) kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të KPK-së, nuk është dorëzuar gabimisht në Gjykatën Kushtetuese; dhe (ii) që kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së vendimeve të kontestuara të KPK-së, është vendosur nga Gjykata Kushtetuese dhe nuk është dorëzuar/nuk ka arritur në Gjykatën Themelore, pas afatit nga “organi jo-kompetent” sipas kërkesave të ligjit të aplikueshëm. Në këtë kontekst, Gjykata gjithashtu thekson që “kjo kërkesë nuk ka arritur në gjykatën e shkallës së parë pas afatit dhe e pa shqyrtuar për tu nxënë afati si pretendon paditësi dhe për tu trajtuar si padi e po ashtu nuk mund të thirret në fakte se nuk e ka ditur apo se gabimisht e ka paraqitur në Gjykatë Kushtetuese, gjer sa kërkesa i është drejtuar asaj gjykate, pa i shtjerrë mjetet juridike në procedurë të rregullt gjyqësore të konfliktit administrativ me padi për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve përfundimtare administrative, ashtu si parashihet me dispozitat e cekura të LKA-së.
110. Ndërsa, në kontekst të pretendimit që bazuar në nenet 129 dhe 130 të LPK-së, Gjykata Themelore do të duhej të miratonte kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, gjykatat e rregullta, në esencë, saktësuam që nenet e lartcekura të LPK-së, janë të aplikueshme për afatet procedurale gjatë shqyrtimit procedural të një rasti dhe nuk vlejné për kthimin e afatit për paraqitjen e padisë. Në këtë kontekst, Gjykata Themelore, ndër tjerash, theksoi që “[...] edhe kërkesa për kthim në gjendje të mëparëshme nuk i përgjigjet rasteve të përcaktuara me dispozitat e nenit 129 dhe 130 të LPK-së – Ligji 03/L-006, pasi që kthimi në gjendjen e mëparëshme bëhet në rastet kur për një çështje ligjore veç se është filluar procedimi gjyqësor, gjat të cilit ndonjëra nga palët pjesëmarrëse për shkaqe të justifikueshme ka humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural. Të njëjtin qëndrim e mbajti edhe Gjykata e Apelit, e cila ndër tjerash, theksoi që “kthimi në gjendjen e mëparëshme, lejohet në rastet kur për një çështje gjyqësore veç se është filluar, përkatësisht është duke u zhvilluar procedura gjyqësore, gjatë të cilës ndonjëra nga palët për shkaqe të arsyeshme ka humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural. Kurse në rastin e paditësit, në Gjykatën e shkallës së parë është bërë vetëm veprimi i dorëzimit të padisë me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimeve të KPK-së, dhe se nga Gjykata nuk është ftuar ndonjëra nga palët që të ndërmerr ndonjë veprim procedural, i cili do të lidhet me ndonjë afat ligjor apo gjyqësor, e i cili afat në rast se do të lëshohet nga palët për të kryer ndonjë veprim të urdhëruar nga Gjykata, atëherë do të aplikohet instituti i kthimit në gjendjen e mëparëshme, por jo edhe siç pretendon paditësi”. Në fund, qëndrimin e Gjykatës Themelore dhe të Apelit, respektivisht, përkitazi me aplikueshmërinë e neneve 129 dhe 130 të LPK-së, respektivisht, e konfirmoi edhe Gjykata Supreme, dhe e cila, në këtë kontekst, ndër tjerash, theksoi që “gjykatat e themeluara sipas Ligjit për Gjykatat nuk janë kompetente të rivendosin një afat ligjor prekluziv të humbur nga vetë pala paditëse i

*cili nuk ka vepruar ashtu si parashihet me ligj për të paraqitur padi në Gjykatë Themelore në Procedurë të Konfliktit Administrativ në afatin e lejuar ligjor. Sipas nenit 129 të LPA përcaktohet rivendosja e afateve por vetëm pas fillimit të veprimeve procedurale pas paraqitjes së padisë e tutje, nëse pala nuk shkon në seancë apo e humb afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural. Sipas kësaj dispozite rregullohet kthimi i gjendjes së më parme esencialisht që palës ti lejohet të ndërmarrë ndonjë veprim procedural të cilin nuk e ka ndërmarrë brenda afatit të caktuar ose që palës ti lejohet të marrë pjesë prapë në seancë të re në se ka arsye të bazuara për humbjen e afatit për ndonjë veprim procedural, ligjor apo gjyqësor”.*

111. Bazuar në sqarimet e dhëna nga gjykatat e rregullta në kontekst të (i) pasaftshmërisë së padisë së parashtruesit të kërkesës të paraqitur në Gjykatën Themelore; dhe (ii) mosaplikueshmërisë së neneve 28 të LKA-së dhe 129 dhe 130 të LPK-së, Gjykata, fillimisht thekson që, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe atë të Gjykatës, në parim, nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së [García Ruiz kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih gjithashtu rastet e Gjykatës: [KI145/20](#), parashtruese *Hafize Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 34; [KI49/19](#), parashtrues *Limak Kosovo International Airport J.S.C. "Adem Jashari"*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 48; [KI28/23](#), parashtrues [Rrahim Haliti](#), Aktvendim për papranueshmëri i 26 qershorit 2023, paragrafi 55).
112. Thënë këtë, Gjykata gjithashtu thekson se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së dhe e Gjykatës gjithashtu, përcaktojnë rrethana në të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe KEDNJ-në (shih, rastin e GJEDNJ-së, [Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës](#), Aktgjykim i 25 janarit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës [KI154/17 dhe KI05/18](#), parashtrues *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 gushtit 2019, paragrafi 64). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlihet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “*aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar*” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*” për parashtruesin përkatës.
113. Në rrethanat e rastit konkret, dhe marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës lidhur me cenimin e të drejtës së tij për qasje në drejtësi, Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, duhet të vlerësojë, nëse qëndrimet dhe arsyetimet e gjykatave të rregullta lidhur me afatshmërinë e padisë së parashtruesit të kërkesës së paraqitur në Gjykatën Themelore, i nënshtrohen një interpretimit tejet formalist të ligjit të aplikueshëm, duke e cenuar të drejtën e parashtruesit të kërkesës për qasje në drejtësi, përkatësisht nëse interpretimit përkatës i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta (i) ndjek një qëllim legjitim; dhe (ii) është proporcional me qëllimin e ndjekur.
114. Në kontekst të kriterit të parë, përkatësisht qëllimit legjitim, Gjykata rikujton që praktika gjyqësore e GJEDNJ-së është konsistente që respektimi i afateve procedurale të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm, ndjek qëllimin legjitim të sigurisë juridike dhe

të administrimit të duhur të drejtësisë. Gjykata thekson që vendimet e gjykatave të rregullta, bazohen në nenin 27 të LKA-së, bazuar në të cilin, afati për fillimin e konfliktit administrativ është qartazi tridhjetë (30) ditë nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës, ndërsa nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar, padia përkatëse mund të paraqitet brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti. Duke respektuar afatet ligjore për iniciimin e konfliktit administrativ të përcaktuara saktësisht në ligjin e aplikueshëm, përkatësisht LKA-në, Gjykata vlerëson që gjykatat e rregullta kanë ndjekur qëllimin legjitim të respektimit të parimit të sigurisë juridike dhe të administrimit të duhur të drejtësisë.

115. Thënë këtë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe Gjykatës, kjo e fundit, në kontekst të garancive kushtetuese përkitazi me qasjen në drejtësi, duhet të vlerësojë nëse qasja e gjykatave të rregullta mund të ketë qenë tejet formaliste në interpretimin e neneve 28 të LKA-së dhe 129 dhe 130 të LPK-së, duke rezultuar në pasoja jo-proporcionale për parashtruesin e kërkesës, përkatësisht cenim të së drejtës në qasje në drejtësi.
116. Në vlerësimin nëse interpretimi i afateve ligjore të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm, përkatësisht LKA-në dhe LPK-në, nga gjykatat e rregullta është proporcional me qëllimin legjitim të administrimit të duhur të drejtësisë dhe parimit të sigurisë juridike, Gjykata, i referohet parimeve të themeluara përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së. Në këtë kontekst, dhe siç është sqaruar më lart, Gjykata fillimisht thekson se bazuar në këtë praktikë gjyqësore, çdo rast duhet të vlerësohet në dritën e karakteristikave të tij, duke balancuar (i) nevojën që të evitohet qasja tejet formaliste e interpretimit të ligjit dhe që do të mund të cenonte drejtësinë e procesit në tërësinë e tij; dhe (ii) evitimin e fleksibilitetit të tepruar në interpretimin e ligjit që do të dëmtonte sigurinë juridike të synuar përmes kriterëve procedurale të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm. Në mënyrë që të saktësohet balanci i nevojshëm në mes këtyre dy parimeve, Gjykata i referohet edhe një herë, praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, përmes të cilës, është trajtuar qasja në drejtësi nga perspektiva e interpretimit të kriterëve ligjore përkitazi me afatet procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, përkatësisht rasteve a) [\*Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke\*](#), cituar me lart; b) [\*Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës\*](#), cituar me lart; c) [\*Ivanova dhe Ivashova kundër Ruisisë\*](#), cituar me lart; dhe d) [\*Clavien kundër Zvicrës\*](#), cituar me lart.
117. Gjykata rikujton që GJEDNJ-së, kishte (i) konstatuar shkelje në rastet [\*Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke\*](#) dhe [\*Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës\*](#); (ii) kishte konstatuar pjesërisht shkelje në rastin [\*Ivanova dhe Ivashova kundër Ruisisë\*](#); dhe (iii) nuk kishte konstatuar shkelje në rastin [\*Clavien kundër Zvicrës\*](#).
118. Bazuar në sqarimet e dhëna në rastet e lartcekura të GJEDNJ-së, në parim GJEDNJ, kishte konstatuar shkelje në rastet në të cilat, (i) afatet procedurale ishin llogaritur nga momenti kur vendimi i kontestuar i gjykatës përkatëse ishte nxjerrë dhe jo nga momenti kur i njëjti ishte publikuar, siç është rasti [\*Miragall Escolano dhe të Tjerët kundër Spanjës\*](#), në të cilin ndër tjerash, ishte theksuar që llogaritja e afateve procedurale nga momenti i vendimmarrjes dhe jo nga momenti kur vendimi përkatës ishte bërë publik, vendos një barrë jo-proporcionale në palët përkatëse, duke rezultuar edhe në cenimin e të drejtës për qasje në drejtësi të garantuar përmes nenit 6 të KEDNJ-së; (ii) afatet procedurale janë llogaritur nga momenti i marrjes së vendimit dhe jo publikimit të tij, duke i pamundësuar palës përkatëse, siç është rasti [\*Ivashova kundër Ruisisë\*](#), në të cilin edhe përkundër tentativave të vazhdueshme të parashtrueses përkatëse, e njëjta ishte vënë në pamundësi për të respektuar afatet procedurale të përcaktuara në ligj si rezultat i veprimeve të autoriteteve përkatëse

publike; apo edhe (iii) kur ankesat e palëve përkatëse janë refuzuar si të pasafatshme nga Gjykata Kushtetuese, në rrethana në të cilat, ligji i aplikueshëm, përfshirë praktika gjyqësore, nuk reflektonin qartësinë e duhur nëse para ankesës në Gjykatën Kushtetuese duhej të shterohej vetëm mjetet e zakonshme apo edhe të jashtëzakonshme të ankesës, në rrethana në të cilat, ligji i aplikueshëm ishte amendamentuar në ndërkohë për të ofruar këtë qartësi, para vendimmarrjes së Gjykatës Kushtetuese përkatëse, siç është rasti [\*Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke\*](#).

119. Në anën tjetër, GJEDNJ-së, nuk kishte konstatuar shkelje të parimit të proporcionalitetit, në ato rrethana, në të cilat, ligji i aplikueshëm ishte i qartë dhe afatet procedurale ishin aplikuar nga momenti i publikimit të vendimeve të përkatëse. Më saktësisht, në rastin *Ivanova*, GJEDNJ, kishte vënë theks në faktin që palët janë të detyruara të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm në mbështetje të rasteve të tyre, duke përfshirë vëmendjen e nevojshme për detyrimet procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme. Ndërsa, në rastin *Claiven kundër Zvicrës*, kishte refuzuar pretendimet e parashtruesit përkatës për cenim të së drejtës në drejtësi si qartazi të pabazuara përkundër faktit që i njëjti kishte parashtruar një ankesë në Gjykatën përkatëse Federale, bazuar në këshillën e gabuar juridike të Gjykatës përkatëse Kantonale, si pasojë e ndjekjes të së cilës, Gjykata Federale e kishte refuzuar ankesën e tij si të pasafatshme. Ligji përkatës federal, ngjashëm me rrethanat e rastit konkret, përmbante dispozitat ligjore bazuar në të cilat, dhe ndër tjerash, (i) paqartësia në kontekst të mjeteve juridike dhe afateve procedurale nuk mund të rezultonte në dëm të palëve në proces; dhe (ii) gjykatat mund të lejonin kthimin e afatit procedural, nëse si rezultat, i ndër tjerash, njoftimit të pasaktë, pala përkatëse mund të ketë humbur afateve procedurale. Përkundër këtyre dispozitave, GJEDNJ, vuri theks në faktin që respektimi i afateve procedurale të përcaktuara në ligj është qëllim legjitim i ndërlidhur me parimin e sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe që gjykatat e rregullta/vendore, nuk kishin interpretuar ligjin e aplikueshëm në mënyrë tjetër formaliste, sepse përkundër faktit që Gjykata përkatëse kantonale kishte dhënë këshillën e gabuar juridike në kontekst të afateve për paraqitjen e ankesës, (i) kur palët përfaqësohen nga avokatë, kërkesat për vlerësimin e saktë të mjeteve juridike dhe afateve procedurale janë më të larta; dhe (ii) avokati përkatës mund të ketë pasur të qartë gabimin në këshillën juridike përkatëse duke u referuar dhe respektuar ligjin e aplikueshëm.
120. Gjykata thekson që rastet në të cilat GJEDNJ-së ka konstatuar shkelje të së drejtës në kontekst të qasjes në drejtësi nga perspektiva e interpretimit të afateve procedurale të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, dallojnë përmbajtësisht nga rrethanat e rastit konkret. Ky i fundit, nuk ndërlidhen me aplikueshmërinë dhe llogaritjen e afateve procedurale në atë mënyrë në të cilën të njëjtit, përkatësisht parashtruesit të kërkesës, do të i jetë pamundësuar paraqitja e padisë brenda afateve kohore të përcaktuara në LKA. Për më tepër, rrethanat e rastit konkret, dallojnë në mënyrë përmbajtësore dhe nga dy Aktgjykimet e Gjykatës në të cilat ajo ka konstatuar shkelje të së drejtës në qasje në drejtësi si rezultat i interpretimit tejet formalist të afateve të përcaktuara në ligjet e aplikueshme, përkatësisht Aktgjykimeve në rastet KI55/21 dhe KI54/21, sepse siç është sqaruar më lart, paditë përkatëse ishin shpallur të pasafatshme pas rreth pesëmbëdhjetë (15) vite procedurash gjyqësore dhe për më tepër, pasi vet gjykatat përkatëse kishin trajtuar disa herë meritat e kërkesëpadive përkatëse, duke mos e kontestuar afatshmërisë e padive fillestare të parashtruara në vitin 2004, deri në vendimmarrjen e dytë përkritazi me rastet të Gjykatës Supreme në vitin 2021.
121. Në fakt, në rrethanat e rastit konkret, është e qartë që (i) aktet e kontestuara të KPK-së, janë bërë publike më 6 prill 2022; (ii) bazuar në nenin 27 të LKA-së, konflikti administrativ do të duhej të jetë iniciuar tridhjetë (30) ditë pas dorëzimit të aktit

administrativ përfundimtar ose gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerrë akti; ndërsa, (iii) parashtruesi i kërkesës padinë në konflikt administrativ e ka dorëzuar më 28 korrik 2022. Në anën tjetër, sipas përcaktimeve të nenit 28 të LKA-së dhe interpretimit të gjykatave të rregullta, nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës, por “*organit tjetër jo-kompetent*”, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e “*mos dijës apo e gabimit të hapur të paraqitësit*”. Në rrethanat e parashtruesit të kërkesës, (i) kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara të KPK-së i është dorëzuar më 28 prill 2022 Gjykatës Kushtetuese, dhe e cila, nuk ka refuzuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mungesë kompetence, por ka vendosur që kërkesa e parashtruesit të kërkesës është e papranueshme si rezultat i mosshërimit të mjeteve juridike të përcaktuara me ligj; dhe (ii) është e qartë që Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencën për të referuar/dorëzuar kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve të kontestuara në Gjykatën Themelore në mënyrë që e njëjta të i ketë “*arritur*” gjykatës përkatëse pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë për qëllime të nenit 28 të LKA-së. Për më tepër, dhe në fund, përfshirë sipas interpretimit të gjykatave të rregullta, sipas përcaktimeve të nenit 129 të LPK-së, procesi kontestimor kthehet në atë gjendje në të cilën ndodhej para mosveprimit, në qoftë se pala nuk shkon në seancë fare apo e humbë afatin për kryerjen e ndonjë veprimi procedural të lidhur me afat, po që se gjykata përkatëse konstaton se ekzistojnë shkaqe të arsyeshme të cilat nuk kanë mundur të parashikohen e as të evitohen. Në rrethanat e rastit konkret, sipas interpretimit të gjykatave të rregullta, kërkesa për kthimin në gjendjen e mëparshme, nuk ndërlihet me humbjen e afateve procedurale gjatë zhvillimit të procesit kontestimor, por me humbjen e afatit për iniciimin e konfliktit administrativ, afati përkitazi me fillimin e të cilit, është qartazi i përcaktuar në nenin 27 të LKA-së. Gjykata, në këtë kontekst, rikujton rastin e GJEDNJ-së, përkatësisht [\*Clavien kundër Zvicrës\*](#), në të cilin, në rrethana të ngjashme dhe dispozita gjithashtu të ngjashme të ligjit të aplikueshëm, GJEDNJ nuk kishte konstatuar shkelje të së drejtës në qasje në drejtësi sipas përcaktimeve të nenit 6 të KEDNJ-së.

122. Marrë parasysh sqarimet e mësipërme, përfshirë edhe parimet që burojnë përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, Gjykata nuk mund të konstatojë që gjykatat e rregullta kanë interpretuar ligjin e aplikueshëm në mënyrë tejet formaliste apo arbitrare, duke rezultuar në barrë jo-proporcionale për parashtruesin e kërkesës. Përkundrazi, në respektimin e afateve të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm përkitazi me iniciimin e konfliktit administrativ, interpretimi i gjykatave të rregullta, (i) ka ndjekur qëllimin legjitim të parimit të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë; dhe (ii) është proporcional me qëllimin e ndjekur. Për më tepër, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së e të shtjelluar më lart, përmes të cilës, gjithashtu është vënë theks në detyrimin e palëve për të ndjekur hapat procedural me kujdesin e duhur, me theks në rastet kur janë të përfaqësuar përmes avokatëve, dhe bazuar në kërkesat që burojnë nga ligji i aplikueshëm.
123. Për pasojë, dhe duke marrë parasysh specifikat përkatëse të rastit, përfshirë parimet e përgjithshme që burojnë nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së në kontekst të së drejtës në qasje në drejtësi, me theks në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në trajtimin e kësaj të drejte nga perspektiva interpretimit të ligjit në kontekst të afateve dhe kritereve procedurale, dhe duke e balancuar, (i) nevojën që të evitohet qasja tejet formaliste e interpretimit të ligjit dhe që do të mund të cenonte drejtësinë e procesit në tërësinë e tij; dhe (ii) evitimin e fleksibilitetit të tepruar në interpretimin e ligjit që do të dëmtonte sigurinë juridike të synuar përmes kritereve procedurale të përcaktuara në ligjin e aplikueshëm, Gjykata vlerëson, që Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, nuk është në kundërshtim me nenin 31 të Kushtetutës



në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse i njëjti, në interpretimin e dispozitave respektive të LKA-së dhe LPK-së, ka ndjekur një qëllim legjitim, përkatësisht atë të respektimit të parimit të sigurisë juridike dhe administrimit të duhur të drejtësisë dhe interpretimi i ligjit përkatës është proporcional me qëllimin legjitim të ndjekur, duke mos rezultuar kështu në cenimin e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në drejtësi.

124. Përfundimisht, Gjykata konkludon se në rrethanat e rastit konkret, nuk ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] të KEDNJ-së.

### PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 28 shtator 2023, njëzëri:

### VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme;
- II. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi [ARJ. nr. 114/2022] i 23 dhjetorit 2022 i Gjykatës Supreme në ndërlidhje me Aktvendimin [AA. nr. 650/2022] e 1 shtatorit 2022 të Gjykatës së Apelit dhe Aktvendimin [A.nr.1875/22] e 2 gushtit 2022 të Gjykatës Themelore, nuk janë në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktgjykim palëve dhe, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare;
- IV. TË KONSTATOJË që Aktgjykimi hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani